


Kujtim Buza, të pikturosh të gjithë Shqipërinë



Nga Bashkim Ahmeti

Gjuha shqipe si tipar
themelor i përbashkësisë
etnike dhe kombëtare
Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj
(fq. 10)

SHËNIME MBI LIBRAT

PËR RIBOTIMIN E ROMANIT
TË PARË NË GJUHËN
SHQIPE - "MARCIA",
TË DOM NDOC NIKAJT

Nga Tefë Topalli (fq. 6)

Parathënie për romanin e Mehmet Krajës
"Im atë donte Adolfin"

Një roman i domosdoshëm
në gjuhën malazeze

Nga Dragana Erjavshek (fq. 7)

Kadare, bashkëkohës i epikes
nga Alketa Spahiu

Një studim i thelluar mbi
universin kadarean

nga Mira Meksi (fq. 8)

Romani "Shëmtia" i Raimonda Belli Gjençajt, Dituria

DY FYTYRAT E "SHËMTISË"

Nga Prof. Dr. Klara Kodra (fq. 9)

Vështrim i përgjithshëm mbi romanin *Granti* të autores
Dhurata Haxhiu Kasa (Toena, 2024)


"Granti", një roman për njeriun
në mes të dy sistemeve

Nga Albi Lushi (fq. 12)

"Gjuha, letërsia dhe filmi" i autorit Enver S. Morina

Libër me vlerë mbi
personalitetet e çmuara

Nga Bashkim Hoxha (fq. 15)



Portreti: P. Përvathi

Mjedja... i plotë, i pacensuruar dhe aristokrat

Nga Frano Kulli

(fq. 4)

E gjithë lënda poetike, por edhe shkrimet e tjera janë marrë nga Ebotimet e para, më të hershmet, duke ruajtur origjinalitetin e tyre dhe, aty ku është parë e nevojshme, është bërë edhe shpjegimi i fjalëve e shprehjeve me përdorim më të rrallë.

Nga presioni shoqëror te kategoritë estetike;


Gratë që bënë letërsi me pseudonime burrash
GEORGE ELIOT, J. K. ROWLING, CHARLOTTE BRONTË
dhe revolucioni autorial letrar

Nga Jola Tasellari (fq. 17)

Han Kang, "Vegetariania".

Ëndrra kundërvënie e
realitetit jetësor dhe
përligjje e tragjikes së tij

Nga Anton Nikë Berisha (fq. 18)



BIBLIOTEKË

Giovanni Verga (fq. 13)

Kavaleria rustikana

Përktheu: Zija Vukaj

Artur Spanjoli (fq. 14)

*Ana Kalt, portreti i një
aktoreje*

Shefkije Islamaj (fq. 16)

Duke pritur shiun

Enver Kushi (fq. 19)

Retë e Çamërisë

Adrian Lesenciuc (fq. 20)

Gjuha e Jezusit

Përktheu nga rumanishtja: Luan Topçiu

Eduard A. Skufi (fq. 21)

Dramë në portretin e një fëmije

Arben Meksi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Një Hamlet pa fjalën. Baleti
i tragjedisë dhe emocioneve
universale

Nga Visar Zhiti

Si një gjeni i teatrit dhe hulumtues i shpirtit njerëzor, mjeshër i fjalës, Shekspiri a do ta vlerësonte aftësinë e kësaj shfaqjeje për të përcjellë konfliktet e brendshme jo si i ka shkruar ai, por përmes lëvizjes dhe estetikës vizuale?

Kur unë isha nxënës në Liceun Artistik, Kujtim Buza sapo kishte mbaruar institutin e lartë të Arteve dhe ishte drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Përveç Galerisë Kombëtare në Tiranë ishte edhe një galeri për shitjen e veprave të artit. Këto ishin gjithçka që të ofronte kryeqyteti për artet andaj edhe drejtori i Galerisë Kombëtare binte në sytë e në vëmendjen tonë që studionim të bëheshim piktorë.

Galeria Kombëtare e Arteve ishte e strehuar në një vile të bukur te rruga "Fortuzi" që ishte një rrugë e qete me shtëpi tipike tiranase dhe vila në stilin modern të viteve '30 të shekullit të kaluar. Këto shtëpi e vila me oborre e kopshte dhe me dyer te bukura prej hekuri të rrahur dhe porta druri të vjetra, të lyera e të mbajtura me kujdes, përcillnin një ndjenje paqësore harmonie e mirëqenieje që ishte krejt e ndryshme nga romantizmi i gjëmshëm që përjetoje në peizazhin marramendës të Gjirokastrës nga vija unë. I joshur nga bukuria e koleksionit modest dhe nga harmonia e qetësia disi misterioze e mjediseve të galerisë, shkoja shpesh, herë i vetëm a here me ndonjë shok. Dikur, kjo vilë e jashtëzakonshme kishte qene shtëpia e një kryeministri të mbretërisë, gjë që ia shtonte edhe me shume solemnitetin koleksionit të veprave të cilat ishin edhe ato më së shumti punime të artisteve që vinin nga ajo kohë.

Pothuajse gjithmonë do të përshëndeteshe aty me drejtorin e galerisë, i cili e kishte marrë vesh që ne ishim nxënës të Liceut Artistik dhe duke hyre a duke dale prej zyrës na sugjeronte me thjeshtësi e mirësjellje here një pikture e herë një tjetër për të cilat na bënte edhe një paraqitje të shpejte. Drejtori, Kujtimi, ishte një djalë i hijshëm e i veshur me kujdes dhe disi ndryshe nga të tjerët si shumica e ish studentëve të kthyer nga vendet e lindjes komuniste. Ai ishte djali i Abdurrahim Buzës, mësuesit tonë të admiruar. Buzën gjithashtu e hijeshonte brerorja e ndritur e Akademisë së Arteve të Firences, dhe kjo e bënte edhe Kujtimin të dukej për ne disi më familjar. Në të vërtetë, ai na priste sikur të ishim njëfarësoj të brendshëm dhe të "klubit". Gjatë njërës nga këto vizita, Kujtimi më dhuroi një monografi për piktorin Zef Kolombi, që ishte punimi i tij i diplomës për kritikë e histori arti në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë. Ishte një libër i hollë me pak riprodhime në bardhezi. I emocionuar, e mora librin si një dhuratë shumë të veçantë që më bëhej. Edhe pse në dukje modest, libri ishte sidoqoftë një monografi për një piktor shqiptar, një libër arti në shqip. I pari libërth arti që botohej në Shqipëri dhe i pari që kam lexuar. Pikturat e Zef Kolombit që ishin po aty në muret e galerisë, në libër ishin të shoqëruara me histori e analiza dhe dukeshin në sytë e mi prej nxënësi, solemne e plot me kuptime të fshehta.

"Shqiptarit", thoshte Çajupi, "po i tregove një gjë të shkruar e të shtypur në libër, e merr atë për ungjill".

Ky libër i hollë, si edhe shkrimet që Kujtim Buza i botonte në Gazetën "Drita" a në revistën "Nëntori", ma kishin mbushur mendjen që ai ishte kritik arti me rëndësinë. Në mendjet tona të atëhershme, kjo puna e kritikut më shume kuptonte një post zyrtar se sa një profesion. Sidoqoftë kisha bindjen që kritikët dhe studiuesit e letërsisë dhe arteve ishin njerëz me ca funksione në shtet që dukeshin shumë me rëndësi, paçka se në të vërtetë ata nuk kishin shumë në dorë.

Në vitet që pasuan, shumë prej tyre u kritikuan e u dënuan për gabime të ndryshme, sidomos "ideologjike", por kjo ma shtonte edhe më shumë përshtypjen e krijuar për ta si njerëz të rëndësishëm. Veç kësaj, Kujtimi as që ekspozonte piktura e as vizatime të vetat. Ekspozoi një herë në një "Nëntor" një peizazh propagandistik, të bërë enkas për ekspozitën. Tjetër nuk mbaj mend. Edhe pse e kisha pare me shumë

KUJTIM BUZA: TË PIKTUROSH TË GJITHË SHQIPËRINË

Nga Bashkim Ahmeti Izano, piktor



vëmendje punimin e tij të diplomës të Liceut Artistik të varur në murin e studios se të atit, Buzës plakut, punime të tjera të varura nuk kisha parë. As të shkollës. E kisha ndarë mendjen që ai nuk ishte piktor. Dhe jo vetëm unë, kështu besoj mendonin edhe shokët e mi të Liceut Artistik. Ai erdhi si i dërguar i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, kryetar i komisionit të vlerësimit të diplomave tona të maturës dhe kjo e nguliti në mendjen tonë edhe si zyrtar. Gjatë viteve të mija të studimeve e më vonë dalëngadalë ne krijuam një lidhje që ishte disi miqësore.

Në fillim të të shtatëdhjetave unë punoja në Gjirokastër dhe e takova Kujtimin në zyrën e tij, siç bëja sa herë vija në kryeqytet. Sa ishte kthyer nga një vizitë në Kosovë

dhe thjeshtë e si pa rëndësi me tregoi një bllok të tërë me vizatime që i kishte bërë gjatë udhëtimit. Ishin të thjeshta e plot me detaje të bëra me mjeshtëri, përshkruese e pa poza virtuoze e as pretendime stilistike. Thjeshtë mbresa udhëtimit. Këto vizatime ai i tregonte pa përtuar, më shume si për të treguar çfarë kishte parë në Kosovën e dashur të origjinës së tij se sa për të treguar vizatimet e veta për të cilat ai, me gjithë përmbajtjen e modestinë, dukej që ishte krenar. E dija që Kujtimi kishte studiuar krahas teorisë dhe historisë së artit edhe pikturë e vizatim. Edhe në Peterburg, ku ishte i regjistruar në klasën e teorisë, ai ndiqte paralel edhe klasat e vizatimit te pikturës. E dija që në Tiranë

kishte qenë shok shkolle me Naxhi Bakallin e Gavril Priftulin të cilët me të vërtetë i admiroja por si të gjithë edhe unë besoja që kjo puna e pikturës ishte një kapitull i mbyllur për të. Në të vërtetë nuk kishte si të ndodhte ndryshe për të gjithë ne që kishim parë vizatimet e pikturat e bukura e te jashtëzakonshme të Buzës plak. Me siguri kur të gjithë i flisnin me admirim për artin e Buzës plak, të babës, dhe kurrkujt nuk i shkonte ndërmend ta pyeste për vizatimet apo pikturat e tij, ai do të ketë menduar që zor se ka vend për të aty. Mbase ai, si të gjithë njerëzit e talentuar, nuk mundej dot të hiqte dorë kollaj, por mbase ishte vet Kosova ajo që me energjinë magjike që ushtron mbi mendjet e shqiptareve të mirë, e shkundi edhe Kujtimin. Ai i botoi këto vizatime në një libër të vogël e modest për të cilin ai dukej që krenohet që kishte qenë aty dhe kishte vizatuar Kosovën. Këto vizatimet e Kosovës ia kishin rrëmbyer vëmendjen dhe e kishin entuziazmuar edhe Buzën plak dhe kjo besoj për Kujtimin do të ketë qenë si të hidhte hapin më të madh në jetë. E kishte marrë vëmendjen e Abdurrahimit për artin e tij. Buza, herë pas here i përmendte këto vizatime. I përmendte dhe të shikonte në sy si të thoshte se ato janë ashtu siç duhet. Dukej që me të vërtetë i pëlqente.

Edhe ai vet kishte vizatuar gjatë vizitave të tij në kantieret e punës për hapjen e rrugëve të reja dhe në hidrocentralin e Ulzës. Po kështu kishin bërë edhe S. Kaceli, N. Zajmi e të tjerë piktorë. Vizatimet e Buzës të kujtojnë ato të Da Vinci-t. Ato janë të bëra me precizion, e plot me detaje. Kaceli vizatonte lehtë e butë e në mënyrë disi impresioniste. Vizatimet e Zajmit janë më realistike. Foto Stamo vizatonte me penë e disi shkujdesur. Sidoqoftë vizatimet e tyre janë të një lloji të përbashkët. Janë mbresa nga udhëtimet në vende te caktuara. Prej vitesh këto lloj vizatimesh nuk bëheshin më tek ne.

Me ardhjen e studenteve nga vendet komuniste, gjerat kishin ndryshuar. Artistët që kishin studiuar në vendet komuniste as që i ftuan mësuesit e tyre të ditur të Liceut Artistik të jepnin mësim në Institutin e Lartë të Arteve të porsakrijuar. Aty jepnin mësim studentët ende pa e marrë diplomën. Sido që të jetë kjo historia e mësuesve e nxënësve ky momenti i Institutit të Lartë shënon një pikë kthesë për artin shqiptar. Prej atëherë për të mirë e për keq, gjerat ndryshuan përgjithmonë. Studentët e shkollës së arteve shkonin për praktika mësimore në kantiere ndërtimi e në fshatra por jo për të bërë vizatime të thjeshta në blloqe vizatimi me mbresa e shënime, më shumë bënin skica për të gjetur tipin e heroit të kohës ose për të



dalë në dritën e natyrës, që edhe kjo kishte gjithashtu kuptim politik.

Vizatimet e Kujtimit ishin një kthim te vizatimet e brezit të babës së tij. Nuk dua të them që ato tërhiqen vëmendjen e artisteve. Shokët e tij të klasës, Bakalli, Priftuli e Blido, gjithashtu vizatonin bukur e me mjeshtëri. Pikturat e tyre ishin të ngritura mbi vlerat grafike e bukuritë e vizatimit gati si vizatime të ngjyrosura siç edhe i etiketonin akademistët tradicionalistë. Kjo i veçonte ata si të ishin një grup me program dhe me stil të afërt me pikturën moderne dhe teknikat që gjithashtu vinin si një risi. Pikturat e Kujtimit, edhe pse të ndryshme për nga stili, gjithashtu i ngre mbi një imazh të vizatuar direkt me penel e me bojë vaji, si skica me ngjyra. Edhe ne që ishim më të afërt e të miqësuar me të nuk i morëm seriozisht vizatimet e tij përshkruese. Ndofta ato pak kush i mban mend, mirëpo që mbas kësaj ai befasi filloi të pikturoje fort. Pikturonte peizazhe nga natyra duke prurë nga udhëtimet mbresa të freskëta ku natyra është e përshkruar me vëmendje, e në mënyrë të thjeshtë të drejtpërdrejtë dhe ku idetë konvencionale e “kuptimet e mëdha” zbehen e treten për t’ia lënë vendin përshkrimit të imazhit. Vëzhgime të mprehta në kërkim të ngjyrave e nuancave pikturike ku si për çudi nuk janë në qendër objektet që përfaqësonin “idetë e temat e kohës”. Harmonia e ngjyrave dhe e toneve si edhe përpjekja për t’u mjeshtëruar në stilin e pikturës “alla prima” behën në punët e tij tema dhe përmbajtja, arsyeja që e shpije atë tek piktura. Nuk mund të mos i merrje seriozisht këto sprovat e tij me peizazhet e “Plain air” as edhe entuziazmin e tij ndaj një penelate të qëlluar që përcillte refleksionin shpirtëror ndaj natyrës. Edhe pse duket qartazi që ai është i familjarizuar me impresionistët, paleta e tij qëndron te ngjyrat e përmbajtura të intonuar e me tinguj të temperuar. Më shumë realiste e natyraliste se sa optika analitike ose spektrale. Format ndjekin modelin me besnikëri duke u shpërberë shpesh në penelata të rregullta por as edhe një herë në thyerje prizmatike e gjeometrike. Ishte koha kur bëheshin tablotë e mëdha kompozicionale me tema kuptimplota siç quheshin atëherë në mënyrë qesharake, “Tema Kardinale”. Unë vet isha i përkushtuar përkohësisht ndaj peizazheve romanticiste me të cilat më shumë dëshjoja se sa kisha sukses me komisionet e ekspozitave e konkurseve kombëtare.

Ndërkohë, për Kujtimin rëndohej hija që i bënte Buza plak sa më afër që i vinte pleqëria. Mirëpo, befasi, kur askush nuk e priste, e gjitha ndryshoi. E kam të paharruar një vizitë në studion e tij ku ai më tregoi një seri me peizazhe që i kishte pikturuar gjatë një udhëtimi në Austri. Kishin qenë aty me piktorin Fatmir Haxhiu, të ftuar nga një shoqatë piktorësh dhe kishin pikturuar aty së bashku me ta. Spontaniteti dhe freskia e pikturimit “alla prima” i afruan pikturat e tij shpesh të pambaruara me stilin “non finito” që i bënte ato të dukeshin elegante e lirike. Kishte qenë aty si në një provë dhe kishte pikturuar me shpejtësi e i përqendruar.

Kësaj radhe e kuptova që, këtej e tutje, aventura e tij me pikturën ishte serioze e pasionante edhe pse ai vazhdon të hiqej se pikturonte thjesht se i pëlqente ta bënte këtë gjë midis pauzave të punëve të tij në zyrat e Lidhjes së Shkrimtareve dhe Artistëve. Nuk ishte ashtu. Ai e dinte se çfarë donte. Po pikturonte peizazhe të “Plain Air”. Piktura të bëra aty në natyrë, shpejt, shpejt e pa korigjime. Nganjëherë edhe i përsëriste ato në studio sikurse, Van Gogh-u, për hir të freskisë e për të shmangur korigjimet.

Edhe pse me këto piktura nuk i zije dot ballët e sallave të ekspozitave as edhe të merrje çmimet e para, prapëseprapë, ato heshtazi veçoheshin nga shumica e artdashësve si piktura të bukura. E kam në sy një peizazh të Vilson Kilicës, që



besoj në 1969 ishte varur në Bibliotekën e Institutit të Lartë të Arteve në Tiranë. Piktura ishte rreth 1.8 x 1.4 m dhe tregonte malin e Dajtit në një prerje imponante. Kjo pikturë, me një harmoni tërheqëse ngjyrë vjollcë përfaqëson atë që quhej “Peizazhi Monumental” diçka si “Sublime Landscape”. Sali Shijaku bëri një seri me peizazhe dekorative e simboliste sipas vizatimeve që bënte kur shkonte për gjah. Vangjush Mio kishte bërë peizazhe impresioniste në mënyrë si shihej impresionizmi në Itali. Ksenofon Dilo kishte pikturuar peizazhe ekspresioniste dhe pastaj ca peizazhe në një stil gjeometrik. Kamberi e Jonuzi në Vlorë, bënin peizazhe post-impresioniste, Lulani provonte peizazhe historike, Gjergji Marko bënte realizmin post-impresionist alla Marquet, Kokolani kombinonte një stil shkollor me penelatat e Cézanne, ndërsa Lako e Vasili pikturonin liqenin e Pogradecit në një mënyrë të poetizuar.

Siç shihet, panorama e piktoreve peizazhist nuk ishte edhe aq monotone. Kujtimi pikturonte “Plain air” pa u ndalur. Kur i shikon me radhë pikturat e tij, mrekullimin nga natyra, bredhjen në fshatra e zona rurale si dhe harmoninë e kërkuar, të vjen ndërmend Levitan. Peizazhi “Togëz – Librazhd” i vitit 2001 është i pikturuar me ngjyrat e arta të vjeshtës, me një rrjedhje uji në planin e parë e me shtëpizat e vogla të fshehura mbas pemëve në rrëzën e malit që e mbyll hapësirën me siluetin e harkuar si dhe me një dridhje të përmbajtur te penelatave si të shkaktuar nga flladi i ajrit. E gjitha në një qetësi e heshtje që të kujton peizazhet e Levitan, edhe pse stili i Kujtimit padyshim është më i afërt me Édouard Manet. Pikturat me dallgët që shkëmbejnë mbi shkëmbinj të kujtojnë me shumë amerikanin Homer se sa Impresionistin Claude Monet. Kujtimi vozit me kujdes përmes këtyre stileve dhe është zor ta vendosesh se ku qëndrojnë peizazhet e tij. Mbas Mios, ai më shumë se kushdo tjetër, i ishte përkushtuar gjinisë së peizazhit por nuk dukej një ndjekës i tij.

Unë ia pëlqoja pikturat Kujtimit. Më impresiononte autenciteti i tyre dha raportin e thjeshtë e i singertë i pikturës së tij me natyrën. E admiroja mënyrën e tij krejt të pa angazhuar stilistike. Kjo mungesë militantizmi e programizmi i vinte ato në një pozitë të pavarur e origjinale. Për arsye të thjeshtësisë dhe të qasjes së tij aspak agresive, u desh pak kohë që të kuptohej që piktura e tij është krejt ndryshe. Kjo e bëri më të afërt miqësinë tone. Si të thuash më natyrshëm u bëmë miq se ia pëlqenin

pikturat njëri-tjetrit. Kishim një diferencë moshe që mua më impononte një distancim respektimi që më ka mbetur edhe sot e kësaj dite. Kujtimi më priste në zyrën e tij me ngrohtësi. Ashtu i priste të gjithë. Me mirësjellje e me një note humori për t’i liru kolegët nga ngrirja që të shkaktonin zyrat e shtetit komunist.

Në pranverën e vitit 1981 isha në Tiranë dhe u ktheva nga Lidhja e Artistëve për t’u përshëndetur me Kujtimin siç bëja kurdoherë. Kujtimin e gjeja gjithmonë në zyrë ose te salla e kafes ku zbriste për t’ju ofruar kafën e mirëseardhjes veçanërisht artistëve që vinin nga rrethet. Kishim bërë së bashku një peizazh me dimensione të mëdha që ishte porosi nga një institucion shtetëror me rendësi. Punuam me entuziazëm pesë a gjashtë javë me të. Një peizazh 3 x 2.5 m ishte për të dy ne një provë ambicioze dhe gjithashtu një eksperiencë e re. Puna na shkoi mbarë e në harmoni. Veçanërisht me harmoni, pa qenë nevoja për të ndërhyrë e korigjuar mbi atë që bënte secili. Për mua që një eksperiencë e pazëvendësueshme. Veç të tjerash, mësova që kjo puna e peizazhit realistik, nuk ishte në të vërtetë ajo që unë ëndërroja për pikturat e mia, ndërsa Kujtimi, besoj do të jetë bindur që qëndrimi përballë natyrës dhe koncentrimi për ta kryer pikturën gjatë vetëm një seance, ishte motori që ia vinte në lëvizje trurin, syrin dhe dorën.

Gjatë këtyre gjashtë javëve punë me peizazhin përjetuam edhe një tjetër eksperiencë të paharrueshme për mua. U takuam ne barin e Lidhjes për të shkruar prej andej në studion ku punonim peizazhin. Kujtimi më ftoi të ngjitemi shkalleve ku ishte zyra e tij, zyra e sekretarit të Lidhjes. Si hymë, tërhiqja derën, u ul te tavolina e punës, e hapi sirtarin dhe nxori prej andej një zarf të zakonshëm postar. “Këtu në zyrë”, tha, “na vinë edhe letra si kjo që na ka ardhur nga Gjirokastra”. I tha këto me buzën në gaz e vështrimin sfidues ndaj zarfit që e lëshoi mbi tavolinë. Mua më shkoi një dridhje e lehte. E dija se çdo të ishte ajo letër. Një letër anonime. “Lexoje”, më tha me ton të singertë, “besoj do ta kuptosh kush mund të jetë autori”. “Jo”, i thashë aty për aty, “nuk dua ta lexoj. Janë shumë ata që mund ta kenë shkruar”. E dija se çfarë thoshin ato lloj letrash anonime. Thoshin gjëma. Thoshin shpifje dhe të vërteta të shtrembëruara. Kishte shpërthyer një fushatë letrash anonime gjithandej. “Popull Shqiptar Popull Shkrimtar”, thoshte për të Dritëro Agolli.

Kujtimi e hapi sirtarin dhe e futi letrën përsëri në të. “Mirë e ke”, tha, “s’ka ç’të hyn në punë. Ja e kemi këtu”. U ngritëm dhe shkuam në studio. Prite zot rrezikun. Ishte letra e dytë anonime që më dilte përballë. Nuk u përmend më kurrë midis nesh as për shaka e as për ta tallur e as për ta sharë. Kur piktura jone ishte afër fundit na vizitoi Buza plak. “Do të vije baba sot”, tha Kujtimi si për një gjë pa rendësi. “Oh, sa mire”, thash unë. “Besoj që jemi gati”. Në të vërtetë, m’u bë në çast se ne nuk ishim gati. “Donte të vinte javën e kaluar”, tha Kujtimi, që siç duket e ndjeu shqetësimin tim. “I thash të presë edhe ca ditë”. Unë i hodha një vështrim pikturës për ta parë me sytë e profesorit. “Le të vijë”, tha Kujtimi. Buza erdhi i veshur shik me një kostum të shtrenjte e me kollare e kapele republike siç vishej që kurse kishte dalë në pension. Ai dukej i gëzuar që ne po bënim një tablo të madhe. Dukej që ishte kureshtar te shihte a e bënim dot një peizazh në këto përmasa dhe ishte i kënaqur me atë që po shihte. Na beri muhabet për mirësjellje dhe dukej i gëzuar. Na përgëzoi për punën por nuk na bëri vërejtje as sugjerime, vetëm se me shaka e veçoi se ku kishte punuar njëri e ku kishte punuar tjetri. Duke ikur, ndaloi te dera, u kthye edhe një herë nga piktura dhe ashtu në këmbë me buzën në gaz e me sytë ngjyrë çelur që i shndrisnin kur do të thoshte diçka dykuptimshme, na tha që ai vet do të kishte nxjerrë një dyzet piktura nga kjo kanavace. Nuk besova se e kishim ndezur entuziazmin e tij por Kujtimi dukej i kënaqur. Ai i dinte punët më mirë. Më mbeti në mendje se me kujdes e seriozitet e merrte Buza të birin. Mbase edhe mua.

Kujtimi, më së shumti, pikturonte me ngjyra vaji në *cardboard*, një lloj kartoni i presuar ngjyrë kafe. Dukej që sipërfaqja e lëmuar e kartonit e ndihmonte të procedonte shpejt e me shkathtësi, gjë që ia bënte pikturat disi të përpikta e virtuozë edhe pse pa gjeste dhe penelata të ekzagjeruara. Ngjyra kafe e *cardboard*-it i shërbente si bazë e mirë për jeshilet e errëta, okrat dhe penelatave të shpejta të ndriçimeve. Mendoja që mbas kësaj tabloje ai mbase do të kalonte në përmasa me të mëdha e ne kanavace por edhe për shumë kohe ai pikturoi në *cardboard*. Ai ishte i zënë me punët e zyrës. Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, edhe pse dukej të ishte një vend komod e të këndshëm, me sallonin e madh, me barin luksoz, e me sallën ku shpesh bëheshin koncerte me muzikë dhome, në të vërtetë ishte një fole grerëzash. Ai

(Vijon në faqen 5)

Ky botim i veprës së Ndre Mjedjes është, pa kurrfarë mëdyshjeje botimi më i plotë dhe më autentik i veprës së autorit, që i vjen për herë të parë lexuesit të tij edhe pse, në njëfarë mënyre, nëse i referohemi vetëm një rendi kronologjik i bie që të jetë i treti.

Për herë të parë një përmbledhje të plotë të veprës poetike të Ndre Mjedjes e kemi në vitin 1982. E titulluar "Ndre Mjedja-vepra" e përgatitur nga akademik Sabri Hamiti dhe botuar nga "Rilindja" në Kosovë. Në Tiranë një botim i tillë është ai i vitit 1988 i përgatitur nga studiuesi Rinush Idrizi dhe këto të dy përbëjnë dy botimet më gjithpërfshirëse të veprës së poetit, deri tek ky i yni. Ato vijjnë mbas përmbledhjeve të pjesëshme: "Vjersha dhe poema", sjellë nga Llazar Siliqi, 1953, "Juvenilia dhe vepra të tjera", nga Mark Gurakuqi, 1964, disa të tjera botime të pjesëshme nga Vehbi Bala, Dhimitër Shuteriqi etj.

Ndërkaq "Juvenilia", përmbledhja e parë dhe e vetme e Mjedës, qe botuar qysh në vitin 1917, në Vjenë, kur ai ishte 51 vjeç, në kulmin e pjekurisë së vet letrare... E mirëpritur sa s'ka.

E çmuar dhe e vlerësuar asohere edhe prej një tjetri, kolos të letrave shqipe, At Gjergj Fishta: "Që një vepër poetike, me të cillen mund të thohet, se pernjimend asht stolisë gjuha e rritë pasunia e literaturës shqipe...-shkruan për të Fishta-Prandëj kjo vepër ka me qenë domosdo e nevojshme me u përdorue si tekst nder shkolla të Shqipnisë. Autori mundet me qenë i sigurtë, se atdheu ka me ia ditë per nder mundin qi ka hjekë në përpilim të k'saj vepre."¹

Prej asaj kohe e këndej nuk kemi pasë tjetër botim a ribotim të veprës së plotë të Poetit, megjithatë vepra e Mjedjes, ka qenë gjithnjë e pranishme edhe në shkolla, që nga koha kur përgatitte vetë tekste leximesh. Edhe në periudhën e sundimit të komunizmit poezia e Mjedjes, si dhe botimet studimore e monografike rreth mjeshtrisë e artit të tij, kanë qenë përherë pjesë e historisë së letërsisë shqipe, si dhe objekt studimi i lëndës së letërsisë në shkolla andej e këndej kufirit ndërmjet shqiptarëve.

Porse, siç do të konstatohet prej studiuesve të tij në ndonjë rast "Mjedja, megjithatë ka qenë i keqlexuar e për pasojë i keqreceptuar, në kuptimin që leximi ka qenë i deformuar për shkak të këtyre kufizimeve dhe të shmangjeve prej tekstit original, aq sa perfeksioni stilistikor i Mjedjes i ka lejuar censorët ta bëjnë këtë. Na e bën me dije kështu, përgatitësi i botimit të 1988 në Tiranë, Rinush Idrizi: "...Nga Instituti i Gjuhësisë dhe letërsisë-shkruan ai- u propozua pa asnjë ndrojtje e brejtje ndërgjegjeje, në mos artistike, intelektuale, që botimi i poezisë së Mjedjes të bëhej sipas kriterëve të Kongresit të Drejtshkrimit, për të unifikuar ortografinë e gjuhës së Mjedjes... Dhe ashtu u bë, duke injoruar edhe mënyrën e botimit të veprës së Mjedjes që ishte bërë nga studiuesi më i saktë i tij [para kongresit të drejtshkrimit] Mark Gurakuqi, i cili ishte marrë për bazë edhe në botimin e Kosovës. [1982]"²

Me këtë botim, përmbledhje autentike e përgatitur nga "Botimet Fishta" kemi dëshiruar e synuar që ai, përposë se të plotësonte mungesën më se

MJEDJA... I PLOTË, I PACENSURUAR DHE ARISTOKRAT

Nga Frano Kulli

E gjithë lënda poetike, por edhe shkrimet e tjera janë marrë nga botimet e para, më të hershmet, duke ruajtur origjinalitetin e tyre dhe, aty ku është parë e nevojshme, është bërë edhe shpjegimi i fjalëve e shprehjeve me përdorim më të rrallë.

Synimi ynë gjithashtu ka qenë që t'i sjellim lexuesit të apasionuar të Mjedjes veprën e tij të plotë, më origjinale se kurrë më parë, me bindjen se do të shërbejë edhe për thellimin e studimeve rreth veprës së tij. Po kemi dashtë gjithashtu, që të sjellim në editorinë shqiptare edhe një Mjedje "aristokrat..." siç ai në të vërtetë është, për lexuesin më sqimatar, ani pse nuk është nuk është më i shumti.

tridhjetëvjeçare të Mjedjes në hapësirën e leximit edhe t'i shërbejë sa të jetë e mundur pasurimit të bibliotekave si dhe enteve të tjera të leximit e përmirësimit të teksteve shkollore. Synimi ynë gjithashtu ka qenë që t'i sjellim lexuesit të apasionuar të Mjedjes veprën e tij të plotë, më origjinale se kurrë më parë, me bindjen se do të shërbejë edhe për thellimin e studimeve rreth veprës së tij. Po kemi dashtë gjithashtu, që të sjellim në editorinë shqiptare edhe një Mjedje "aristokrat..." siç ai në të vërtetë është, për lexuesin më sqimatar, ani pse nuk është nuk është më i shumti.

Përreth Mjedjes dhe veprës së tij ka pasë analiza e studime të hollësishme në kohë e rrethana të ndryshme. Ne kemi zgjedhur si pasthënie për botimin tonë punimet e prof. Kolë Ashtës,³ që nisin që në vitin 1940, në revistën "XIV, Aprile", dhe vijojnë deri në vitin 1942 me botimet në revistat "Shkëndija"⁴, në Tiranë dhe në "Kumbona e së Diellës",

³ Kolë Ashta - "Çashtje mbi çashtje", mbledhur e përgatitur nga Prof.Dr. Stefan Çapaliku, Akademia e Studimeve Albanologjike

⁴ "Shkëndija" vj. II, nr 7-8, 1941

Shkoder⁵. Kolë Ashtës, që do vite më pas, saktësisht më 1955-ën do të hartonte "Fjalorin e veprës së Mjedjes", i cili arriti të shohë dritën e botimit vetëm do muaj më parë, njëheri me veprën për të cilën po flasim sot.


Gjithashtu kemi parapëlqyer që, në vend të hyrjes të jetë një ese e shkurtë e Ernest Koliqit, e botuar 35 ditë mbasi autori ndërron jetë.⁶

Kur e shifsh, Dom Ndreu të paraqitej në gjasë të një prifti katundi ndër më të lánunt. Shkurtalal edhe pak si i gërmuqun, verë e dimën mbërthye në një pallto të randë të zezë të përlyeme përpara me pluhun burrnoti, me një fytyrë kuqloshe në të cilën syt e vogjël zhdukeshin nën vetulla të denduna fije-trasha dhe goja nën shllungën e musteqeve të ngathët e vërdhukë: kështu të dilte para Poeti i njimbëdhjetë rrokshave të Lissus e nuk të bante asnjë përshtypje zotsije të veçantë.

Për natyrë perbuzës i çdo reklami

⁵ "Kumbona e së Diellës", Shkoder, nr. 31, 2 gusht 1942, fq. 376-378.

⁶ Ernest Koliqi, "Cirka" nr. 28-29, Shkoder 5 shtatuer 1937



Portreti: P. Pervathi

dhe i çdo esibicjonizmi, urrente lëndin dhe ndryhej ne një pervujtni idhnake qi ishte mësim, qortim i naltë për të gjithë ne. Nuk i rridhte aspak fjala, shprehjet i dilshin copa copa, i qitte prej goje me mundim. Ngatrruhej tue folë e, kur vëhej disi për fije në bisedë përdorte terminologji të thatë. Anmik në shkrim e në jetë i lajleve e i stërholimeve, por jo i panjerezishem, perkundrazi, tue e njoftë s'afermi ndihej në të një edukatë humaniste plot masë e plot mirsi të ndritun dhe shifeshin në të sjellje të zgjedhuna qi dishmojshin qëndrimin e gjatë në rrethe të nalta të hueja.

Dom Ndreu duhej zbulue si njeri dhe si artist. Tue ndejun me të, pikësëpari gjëshe Dijetarin. Kush ndër Shqiptarë mund i krahasohej për kulturë organike? Greqishten e vjetër dhe latinishten i dinte në themel. Qyshë në rini fitoi përjashta konkurse me vjersha klasike.

Shetiti mbarë Europën njherë si nrxanës e ma vonë si Profesor. Banoi në Francë, në Spanjë, në Poloni, në Jugosllavi. Filozof i shquem, mrekuillonte shokët me analiza të reja e me objekcijone të paprituna."

Vepra letrare e Ndre Mjedjes, në këtë botim, i paraqitet lexuesit e strukturuar në dy vëllime. Vëllimi i parë përmban: **Juvenilia**, esenë e At Gjergj Fishtës "D. Ndre Mjedja, Juvenilja", **Vjersha të papërfshira në Juvenilia**, **Vjersha të mbetura në dorshkrim** si dhe artikulli i tij shtjellues teorik: **Permbi poezi pergjithësisht**.⁸


Në vëllimin e dytë do gjeni poemat e papërfshira te "Juvenilia": "Lissus", **Scodra, Liria**; **Vjershat për fëmijë**; Dymbëdhjetë letra të Ndre Mjedjes dërguar albanologut **Gustav Meyer** në vitet 1892-1893, si dhe **Bibliografinë** e veprave të Mjedjes.

E gjithë lënda poetike, por edhe shkrimet e tjera janë marrë nga botimet e para, më të hershmet, duke ruajtur origjinalitetin e tyre dhe, aty ku është parë e nevojshme, është bërë edhe shpjegimi i fjalëve e shprehjeve me përdorim më të rrallë.

Janë sjellë, për herë të parë edhe strofa që, për shkak të rrethanave censuroese të kohës nuk gjinden në asnjërin prej botimeve të mëparëshme

⁷ At Gjergj Fishtës "D.Ndre Mjedja, Juvenilja (Vjenë 1917), Posta e Shqipnisë, 1917/20.

⁸ Punimi "Permbi poezi pergjithësisht" u nxor nga dorëshkrimet e poetit prej Ndue Doçit dhe u botua te "Kombi", në vitin 1941, nr 8-9. (sipas: Rinush Idrizi: Ndre Mjedja, Onufri, Tiranë 2017)



¹ At Gjergj Fishta (Posta e Shqipnisë, 1917/20)

² Rinush Idrizi, Ndre Mjedja, monografia e ribotuar në 2017

Nëse romani “Im atë donte Adolfin” do të ishte një ditë e javës, do të ishte kjo një e diel në agim, nëse do të ishte një stinë, do të ishte fillimi i dimrit, nëse do të ishte një fenomen meteorologjik, do të ishte një shi i imtë nga i cili i tëri i lagur arrin nën një strehë dhe mallkon, lehtë, pothuaj sipas një shprehje, vetveten dhe atë që shpiku shiun, edhe kalendarin, edhe orët dhe gunat, por vlerëson momentin e vetmisë në tokë të terur.

Kështu ndihet edhe lexuesi pas largimit nga ky rrëfim i zymtë, brutal postmodernist-realist; ai nga pak është i zemëruar, pak më shumë i befasu, ndërkaq në fund i kënaqur dhe i plotësuar me atë që ka përfituar nga ajo që ka lexuar.

Konflikti qendror është takimi i dy ideologjive që prekin njëra-tjetrën me forcën e së keqes që kanë prodhuar pa matur apo numëruar viktimat që do të lënë në përfundimin e tyre. Ndarja në stalinistë dhe hitlerianë është edhe lajtmotivi i këtij romani, mustaqet që në një moment do t'i hiqen me dhunë, por edhe triumfalisht gjithë fshatit. Lënë mënjanë atë që ishte i shëmtuar dhe i imtë në krahasim me babën e tregimtarit, protagonist i këtij romani, Hitleri është ai mashkull që arriti të pastronte çizmet e veta para pragjeve të fuqive evropiane para se të shkelte mbi ta, ai burrë të cilit iu bindën më të mëdhenjtë, më të rinjtë dhe më të shëndetshmit nga ai si më i plotfuqishmi dhe më i lartmadhërishti pa vënë në pyetje urdhrat e tij. Prandaj babai letrar i Krajës, vetëm pjesërisht për inat, respekton Fylerin dhe rrezikon me fotografinë e tij dhe njëkohësisht duke imituar pamjen e tij, duke u përpjekur të ndihet më rehat në lëkurën e tij. Nga këndvështrimi i sotëm i mendjeve të arsyeshme, një qëndrim i tillë është bukur mirë konfuz, pasi bëhet fjalë për një kohë kur Hitleri tashmë e kishte humbur luftën. Nga ana tjetër, rinovimi dhe prosperiteti nuk dukeshin ende dhe pyetja është se cili mund të ishte perceptimi i të painformuarve nëse e vetmja gjë rreth vetes së tyre që ata mund të konstatojnë do të ishte represioni i ri, varfëria dhe pashpresa.

Për atë Atë, përkundër iluzioneve që e orientojnë, mungesës së kujdesit të tij ndaj familjes dhe egoizmit, lidhemi në

Parathënie për romanin e Mehmet Krajës “Im atë donte Adolfin”

NJË ROMAN I DOMOSDOSHËM NË GJUHËN MALAZEZE

Nga Dragana Erjavshok

Romani “Im atë donte Adolfin” është vepra e parë e shkrimtarit Mehmet Kraja që vjen në gjuhën malazeze, e përkthyer me përkushtim nga Qazim Muja.

Më poshtë po japim parathënien e romanit nga shkrimtarja dhe kritikja letrare Dragana Erjavshok.

mënyrë emotive dhe simpatizojmë që atë që kërkon në fund edhe ta gjejë, për t'u larguar nga pikat e tij të dyshimta të referencës, Kafja e Madhe dhe Ura e Hekurt, asaj pikës kufizuese mes vlerave dhe pavlerave. Emotivja nuk vjen nga autori dhe narratori i tij, por realizohet drejtpërdrejt te recipientët, pasi narratori i Krajës nuk ka empati në rrëfimin e tij. Ai për babanë e tij flet si për një kuti kartoni përplot me zhavorr ndërtimi që e bart nga një vend në tjetrin dhe që në mënyrë konstante i kthehet vazhdimisht ndër duar. Kështu rrëfen edhe për nënën dhe motrën e tij, me një dozë ironie, në detaje, por krejtësisht të matur dhe pa asnjë pretendim se do t'i duhej të zmadhonte ndonjë veprim të tyre për shkak të lidhjes së gjakut.

Shkodra e pasluftës në romanin e Mehmet Krajës ka atë *erën e rëndë* (post) apokaliptike dhe është shndërruar në një qytet fantazmë (*e çmendur, e zymtë, e zezë nën sy*, të tillë e përshkruan autori) ku enden hijet e karaktereve të dikurshëm, njerëzit e humbur mes botëve, njërës që e mbajnë mend dhe një tjetër që i gjeti të papërgatitur për rendet e reja shoqërore, të pa fat secili në mënyrën e vet, të deformuar në të njëjtën mënyrë. Gjatë rrugës humbën të gjitha busullat morale, u larguan nga njëri-tjetri, në *vetvete*

pa apo me *gërdallën* e vet u shndërrua në mbijetesë vetëm e vetëm për hir të mbijetesës, pa dëshira të mëdha dhe pa destinacione përfundimtare. Prandaj të gjithë personazhet për të cilët rrëfen Kraja janë grupe veçorish të jashtëzakonshme, njerëz të çuditshëm dhe origjinalë, njerëz të shpërfytyruar mendërisht, jo rrallë edhe fizikisht, fatzinj me diagnoza të rënda, pikënisja e të cilëve është frika, e cila degëzohet në dhjetëra marrëzi pasuese. Është e ndershme që autori nuk na la në mosdije, kështu që në fund të romanit të tij ai bëri një pasqyrë të shkurtër të fateve të Myrto Ftjanit, të Izet Smajlit misterioz, Shehnazës, Dan Selmanit, Zefit të çmendur, madje edhe të plakës që shiste sarikanë.


Ky është roman edhe për një bredhje, për kërkimin, më shumë atë meditativ të qenies së vet që asnjëherë nuk është realizuar plotësisht që kur i dështoi plani i parë, por edhe për kërkimin fizik nga Kraja në Shkodër dhe anasjelltas për diçka që Ati, ndonëse as vetë nuk është i sigurt se çfarë është ajo, mund ta pushtonte me duar. Dhe ajo bredhje nuk do të ishte aq e theksuar po qe se në një moment nuk do të zëvendësohej me një prehe, me mungesën e plotë të aksionit dhe aktivitetit, në momentin kur protagonistin mbyllet brenda katër mureve të veta.



Me një gjuhë të shfrenuar të rrugës, të pazarit dhe kafenesë, e cila, duket se, në përkthimin në gjuhën malazeze nuk ka humbur shumë nga *lapërdhia* e saj origjinale, sepse sharje të ngjashme gravitojnë në terrenet kufitare, Kraja përcjell atmosferën autentike, pasqyron shpirtin e njerëzve të thjeshtë, nervozë dhe të lodhur nga lufta, nga lakmia dhe nga e porealizueshmja, por kundërshtues (më shumë se sfidues). Vëzhgimet e tij janë precize dhe të pasura, ndërsa përshkrimet e tij si quadro filmi në të cilat ndërrohen imazhi i gjerë dhe ato fokusat në detaje, të jashtme dhe të brendshme, e shkuara e largët dhe e afërta. Kraja rrëfen sikur i drejtohet dikujt që është i pranishëm, me besim të plotë për njohuritë dhe informacionet e tij, që bie në sy sidomos kur bën me dije se për disa detaje nuk është as koha as vendi. Lexuesit nuk i ngarkon me atë që mund të gjendet në librat e historisë, por fokusohet në llojet e njerëzve që asnjëherë dhe askund nuk janë përshkruar ndonjëherë (të paktën jo aq fuqishëm) në atë mënyrë që të përfundojnë në përjetësi. Aludon në disa ngjarje nga e kaluara si Lufta e Taraboshit, por digresionet e tilla zakonisht janë në shërbim të asaj që është aktuale në harkun kohor që përfshin ky roman.

Sidomos, kur bëhet fjalë për veçoritë stilistike të Mehmet Krajës, bien në sy krahasimet e tij, të cilat duket sikur lidhin paprekshmëritë në një lëmsh kuptimplotë, në gjurmët e P. G. Wodehouse. Ai do të shkruajë: *Të ecje nëpër atë vend në një kohë të tillë, të ngjante si të ecje nëpër një ëndërr të keqe, si të ishe futur në një qyp pëgërash, prej nga nuk arrijë të dilje dot kurrë. Ose: Ëndrra nuk kishte anë tjetër, nuk kishte hyrje dhe dalje, ishte si një mur i vjetër akshihaneje, në të cilin, aty pranë oxhakut, viheshin fotografi kujtimesh, njëra pranë tjetrës.* Këto janë vetëm dy konstruksione që na thonë se romani *Im atë donte Adolfin* na ka qenë i domosdoshëm në gjuhën malazeze (për herë të parë u botua në vitin 2005 në Tiranë) në një kohë kur letërsia po mbytet në shkurtesa, në asociacione të cinguar dhe devijime të panevojshme nga normat për hir të përshtatjes me format dixhitale të komunikimit. Kraja është një autor që nuk i ka harruar modelet e tij të para, por nuk e ka mbyllur shprehjen e tij letrare në themelet e hijeve të të tjerëve, por balancon në mënyrë të përkryer mes dy shkollave letrare, duke gjeneruar një të tretë që një ditë, pa asnjë ekzagjerim, mund ta mbajë emrin e tij.

Përktheu në gjuhën shqipe:
Qazim Muja




Mehmet KRAJA * MOJ JE OTAC VOLIO ADOLFA

MEHMET KRAJA

MOJ JE OTAC VOLIO ADOLFA


roman

Krajinu prozu karakteriše polifoni umjetnički mentalitet, dostojevski tip jezika gdje pisac uspijeva da autora rangira kao ravnopravnog unutar svijeta samih junaka, unutar istog jezičkog nivoa sa njima, da govori kao potpuno ravnopravan sa svim ostalim koji nose junaci u stvaranju polifonije. Njegova proza je često beskrajni dijalog koji se nigdje ne završava, koji nema za cilj jedinstveno rješenje. Cilj njegovog dijaloga izgleda kao trajna i beskrajna protivrječnost koja ni u jednom trenutku ne dopušta nikakvo rješenje.



ISBN 978-9950-638-32-0

BASRI ÇAPRIQI



Përpara pak ditësh, shtëpia botuese Onufri ka nxjerrë në qarkullim një studim shkencor të titulluar: *Kadare, Bashkëkohës i Epikes* të Alketa Spahiut. Me këtë studim shkencor, autorja, *docteur ès Lettres* në Universitetin e Sorbonës, Paris, na fton të eksplorojmë një dimension të ri të veprës së Ismail Kadaresë, duke e vendosur atë në kontekstin e epopesë dhe trashëgimisë së saj letrare. Studimi është një analizë sistematike e mënyrës si Kadareja transformon epikën tradicionale dhe historinë në një rrëfim modern, universal dhe tejet të pasur me simbolizëm. Njëpërmjet një metodologjie të ndarë në tre pjesë kryesore, autorja shqyrton përmasat artistike, narrative dhe stilistike të kësaj letërsie të veçantë.

Ndërtimi i universit epik

Në pjesën e parë, Spahiut trajton mënyrën se si Kadareja krijon një botë me përmasa unike, ku realiteti dhe fantastikja ndërthuren në mënyrë të harmonishme. Disa nga aspektet kryesore të kësaj pjese janë:

- Atmosfera epike dhe mjediset që ajo mbulon

Në romanet e Kadaresë, malet, mjegulla, fshatrat e largëta dhe kështjellat shërbejnë si sfond për ngjarjet. Këto elemente nuk janë thjesht përshkrime gjeografike, por përmbajnë një peshë simbolike që lidhet me përjetësinë, mitet dhe historinë e trashëguar. Vepra të tilla si *Kështjella* dhe *Kronikë në gur* pasqyrojnë jo vetëm realitetin historik, por edhe një atmosferë habie dhe misterie.

- Ndikimi i epopesë në stil

Kadareja i mbështet rrëfimet e tij në strukturën dhe motivet tradicionale të epopesë. Ai nuk ndalet vetëm tek mitet shqiptare, bart dhe ndikimin nga mitologjia greke, duke krijuar një ndërlidhës mes kulturës shqiptare dhe asaj universale. Figura e Orfeut, simbolika e Trojanit, apo reminishencat biblike janë të pranishme në shumë nga veprat e tij, duke u pleksur mjeshtërisht me narrativën kombëtare.

- Hija e realitetit

Alketa Spahiut argumenton se Kadareja ndërton botë ku fantastikja shërben si një metaforë për realitetin historik. Për shembull, makthet kolektive të së kaluarës shqiptare – qoftë ato nga pushtimet, izolimi apo regjimi komunist – paraqiten përmes një narrative që alternon mes reales dhe magjikes.

Sistemi narrativ dhe heroi epik

Në këtë pjesë, autorja Spahiut përqendrohet tek mekanizmat narrativë që Kadareja përdor për të ndërtuar strukturën epike të romaneve të tij. Disa nga çështjet kryesore janë:

- Heroi epik dhe ngjizja e tij

Në universin e Kadaresë, heroi nuk është gjithmonë një individ i jashtëzakonshëm, por shpesh një njeri i zakonshëm që ngrihet mbi rrethanat e tij. Kjo e bën atë të afërt për lexuesin, duke i dhënë një dimension njerëzor. Tek *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* apo *Prilli i thyer*, heronjtë janë figura që luftojnë jo vetëm me botën e jashtme, por edhe me dilemën e tyre të brendshme.

- Marrëdhëniet mes personazheve

Studimi vë në dukje se marrëdhëniet mes personazheve në veprat e Kadaresë janë shpesh pasqyrimet e tensioneve më të gjera shoqërore dhe historike. Për shembull, dualiteti mes Lindjes dhe Perëndimit, e vjetra dhe e reja, përshkruhet përmes dialogjeve dhe konfliktit mes personazheve.

- Oraliteti dhe performanca gojore

Kadareja përthith traditat e oralitetit shqiptar – sidomos ato të epikës së kreshnikëve dhe këngëve historike – duke i transformuar në një stil të shkruar që mbart tingullin e gojëdhënave. Lexuesi shpesh

Kadare, bashkëkohës i epikes nga Alketa Spahiut

NJË STUDIM I THELLUAR MBI UNIVERSIN KADAREAN

nga Mira Meksi

ndien se po dëgjon një tregimtar legjendar që rrëfen ngjarjet.

Stili kadarean dhe epika e shkruar

Në pjesën e tretë, Spahiut analizon stilistikën unike të Kadaresë, duke u përqendruar në teknikat që e bëjnë veprën e tij kaq të veçantë:

- Ornamentimi epik dhe simbolika

Kadareja e përdor ornamentimin – një element tipik i epopesë – për të pasuruar narrativën. Simbolet si gjaku, shpata, drita dhe errësira përshkruajnë konfliktet universale të njeriut, por edhe specifikat historike të Shqipërisë.

- Epika moderne

Studimi përqendrohet tek aftësia e Kadaresë për të krijuar një epikë të shkruar, të ndryshme nga epikat gojore, duke ndërtuar një version të tijin të epopesë. Kjo është një "epikë e individualizuar," ku narratori jo vetëm që rrëfen, por edhe mediton mbi atë që rrëfen. Për shembull,

tek *Ftesë në studio*, Kadareja flet hapur për synimin e tij për të krijuar një libër që tejkalon kufijtë e zhanreve.

- Epika si stil

A. Spahiut thekson se epika për Kadarenë nuk është vetëm një temë apo një motiv, por një mënyrë të shkruari. Ai krijon rrëfime që janë të mëdha në përmasa, ndonëse ngjarjet mund të duken të përditshme apo të « rëndomta », nëse përdorim një shprehje të Kadaresë.

Ky punim i Alketa Spahiut është një kontribut i rëndësishëm për studimet kadareane dhe letërsinë shqiptare. Ai jo vetëm që sjell një perspektivë të re mbi Kadarenë si një "bashkëkohës i epikës," por edhe vë në pah rolin e tij si një ndërlidhës mes traditës dhe modernitetit. Studimi ndihmon, gjykoj, të kuptojmë se si Kadareja përçon identitetin shqiptar në letërsinë botërore, duke e kthyer eposin shqiptar në një gjuhë universale.

Në këtë analizë, universi i Kadaresë



shfaqet si një kozmos i ndërlikuar, ku mitet dhe legjendat takohen me historinë, dhe ku fjala epike bëhet ura që lidh të shkuarën me të tashmen.

Autorja ka sfiduar dhe reinterpretuar poetikën e Kadaresë në mënyrë të thelluar dhe krijuese.

Ky studim mbi oralitetin në veprën e Kadaresë nxjerr në pah gjithashtu një dimension të ri të letërsisë në përgjithësi, duke hedhur dritë mbi marrëdhënien komplekse mes traditës gojore dhe artit të shkruar. Autorja gjen te Kadareja elementë që hasim përgjithësisht në letërsinë botërore të bazuar në trashëgiminë folklorike, duke i dhënë një peshë të re elementeve të oralitetit në strukturën dhe tematikën e veprave letrare të autorëve të mëdhenj.


Përmes analizës së kujdesshme, ajo eksploron mënyrën sesi letërsia e shkruar shkrin mitin, historinë dhe traditën, duke përqafuar një qasje unike që shpesh sfidon normat klasike të narrativës.

Ky studim jo vetëm që e pasuron kuptimin tonë për veprën e Kadaresë, por edhe përshkruan një mënyrë të veçantë të të parit të letërsisë, ku e kaluarja dhe e tashmja ndërthuren në mënyrë organike për të krijuar

Alketa Spahiut

KADARE, bashkëkohës i epikes

Onufri



bëjë disa lëvizje të buta, lëkundëse nga njëra anë në tjetrën, sikur të donte ta ndillte shkrimtarin. E ftoi për vallëzim. Shpatullat e saj të dobëta, tregonin të gjithë vetminë dhe heshtjen e një karrjere që duhej të kishte qenë por nuk kishte qenë. Mbi supet e saj delikatë dhe të brishtë, ku tani atllasi i këmishës ngjyrë qumështi, me mëngët e gjëra, gati transparent, i varej poshtë supeve dhe gjoksit, rrinte e tërë qenja e saj.

Në fillim të vitit nëntëdhjetë kishin filluar të ngjallehin ca shpresa për ndryshim. Askush nuk dinte asgjë, por ato: shpresat, rrinin pezull në ajër. Muri i Berlinin kishte trandur një botë. Aso kohe, i mbante flokët e prerë si mbas modës së viteve 80-të. Po ashtu i kishte flokët edhe kur ai, adhuresi i heshtur e kishte hasur herën e fundit, përgjatë rrugës plot pemë vjeshtore për tek shtëpia e saj. Ç kishte bërë? Kishte ndenjur në heshtje për shumë vite. Derisa ta thërrisnin për ndonjë film të ri. I shihte linjat e fisme të trupit dhe buzëqeshjen e saj disi të hidhur, fisnike.

Kur e kryqëzonte në ecje, ndërkohë që plot padurim, ankth dhe një tmerr të fshehtë, ai kërkonte tjetër gjë, ajo vazhdonte t'i hidhte ca vështrime akute, kurjoze. Pastaj një nënqeshje e lehtë, e bënte të lëvizte cepin e buzës. Nuk e njihnin njëri tjetrin, por njeriu mund të shprehë shumë edhe pa e hapur gojën fare. Ajo e shihte me një admirim plot dhembshuri, pastaj me kureshtje. Një kureshtje e mistershme. Se ç'i thonte në ecje e sipër. Nuk ia ndante sytë, të cilët zakonisht i mbulonte me ca syze të mëdha dhe të errëta dielli.

I lyente flokët korb dhe ishte krejt e dobët në vitin 1989-90. Aq e dobët, sa i dukej se nuk hante fare dhe i dalloheshin muskujt e qafës. Lëkurën e kishte të zbehtë, vishej me fustanet e modës së atyre viteve. Një atë moshë të mitur, adhuresi 19 vjeçar, nuk e dinte ende se njerëzit, do të kujtoheshin veç për atë që linin trashgim në art; jo për si kishin qenë ato në jetën e përditshme. Pra, ajo, do të ishte veç Ana Kalt e filmave. S do të mbahej mend si gruaja e margjinuar, por për personazhet e saj. Kur kalonte, ia dëgjonte takat që kërcisnin fort mbi trotuar. Ecte me një elegancë prej gruaje plot sharm, sikur të ishte duke xhiruar një film. Veç se tani ishte një film tjetër lloj. Filmi i jetës, ku ajo ishte robinë që prej 1974-trës, mbasi e kishin hequr nga Teatri dhe me fare pak të drejta për filma. Gjithçka për hir të një dashurie. Po sa Ana kishin vuajtur në heshtje për 45 vjet? Sa Ana Kalt kishin marrë në qafë? Aq shumë e adhuronin aktrimin e saj. Dhe jo vetëm atë. Adhuronin gjithçka që kishte lidhje me botën e saj.

Pastaj ajo kalonte. Vështrimet e tyre kryqëzoheshin. Ai me fytyrën si meit, krejt të bardhë nga tmerrri i dashurisë, pa frymë, krejt i frikësuar, ajo me buzëqeshjen e saj të ëmbël, pak prej kokete, e cila kur e shihte në ecje, i fliste, oh sa fjalë dashurie dhe adhurimi të heshtur i thonte. Por, një Zot e dinte se çfarë thonte.

Mbas shumë vitesh, e zbuloi pak nga pak. Stinë mbas stine. Në vend që të largohej prej qenjes së tij, prej ndërjegjes së tij, ajo kthehej shpesh. Sidomos kur ai kthehej në vendin e lindjes. Tek ecte rrugëve, mendonte se e kishte fshirë nga kujtesa, kur papritur, kish hedhur sytë nga Teatri dhe e kish parë portretin e saj bardhë e zi, stampuar sa një bojë njeriu, brenda klubit anash Teatrit. Kujtimet në vend që të zhdukeshin, po e sulmonin dhe kafshonin, gjithkund. Një herë, i kish dalë rastësisht në tv, tek kanali që jepte veç filma të vjetër. Kish parë: "Koha nuk pret". Qe i bindur, se tek ai film, ajo kish shpalosur më mirë se asgjëkundi talentin e saj prej aktorje europjane. Ishte ai pra, vetë, që e mbante gjallë kujtimin e saj. Ai dëshironte,

ndaj ajo vazhdonte të jetonte brenda tij. Ndërsa bukurinë e saj si femër, elegancën si të ishte një qenje hyjnore, e kish treguar tek: "Dëshmorët e monumenteve." Aty çdo fotogramë e filmit tregonte mirë stilin elegant dhe të veçantë që e karakterizonte. Vetëm një Anë kishte ekrani jonë dhe ajo e tregonte me talentin e saj, se sa ishte në gjendje të jepte në aktrim. Po i afrohej pak nga pak aktrimin të saj, si gjahtari i afrohet lepurit. Kurjoziteti ia grinte ndërjegjen. Ai besoi përherë se patën nevojë për njëri tjetrin aq shumë, sidomos, fill mbas eksodit të marsit. Mbetën të shkretë që të dy. Ajo pa sytë e princeshave. Ky tjetri pa sytë e asaj gjithashtu. E cila ja kishte mbathur që ditën e parë kur u hap porti. Ç ndodhi? Jo vetëm mbas atyre ditëve të zymta por edhe javët më pas, muajt. Ai, me zemrën krejt të vvarë, sillej andej si nostalgjiku i sapo zgjuar nga varri. Shpesh e haste Anën në ecje. Nga larg shiheshin fare pa drojë. Veç se vazhdonte t'i mungonte fjala. I mungonte fjala. Por sapo i afrohej, krejt i turpëruar nga pesha e ndjenjës mbi supe, skuqej dhe shpesh ulte kokën. Tek sytë e saj, pikaste trishtimin. Ajo i buzëqeshte në ecje, me pak ironi përzier me atë koketërinë e saj alla franceze. "E shikon," dukej sikur i thonte. "Mbetëm vetëm, si dy të mjerë." Bashkeshorti i kishte ikur në fillim të vitit 90, andej nga nuk ktheheshe më. Nuk e kish parë, as shijuar dritën e ndryshimeve. Princeshat, njëra me anije, tjetra me avjon një javë para eksodit, ja kishin mbathur larg asaj toke të nëmur që prej 45 vjetësh. Ndërsa ajo, mbyllur rishtaz në shtëpi, vuante. Sidomos në ditët e para mbas eksodit. Të cilat ishin edhe më të padurueshmet. Ishin si të të vrisnin në shpirt. "E di", i thonte atyre në telefon. "Unë rroj dhe jam e fortë sepse ju egzistoni!" A ishte ndoshta një ngujim dështimi ajo e aktores? Apo mbyllet, që bota të mos ia shihte lotët?! Ai do të kishte pasur dëshirë ta njihje. Tani, pa princeshën, ishte gjithçka më e lehtë. Si i mbushte netët vetmitare me shtëpinë e heshtur, varrezë? Të cilën do ta shisnin shpejt. Në një apartament, ku një burrë kishte ikur aq i ri? Do të donte ta zbrazte lugën me gjellën farmak të obsesjonit të tij, por nuk mundej. Një forcë tjetër e gozhdonte në vend. "Je i çmendur?!" i thonte vetes. "As nuk e njeh fare nga afër!" U pendua aq shumë, sa vite më vonë, hidhej pa skrupull në njohje të reja, si e si për të marrë hak ndaj vetvetes. "Bëje tani!" i thonte vetes. "Se po nuk e bëre, do bëhesh pishman për tërë jetën!" Nuk besonte se dëshironte të ngrinte mitin e dashurisë së madhe. Edhe pse e dinte që artistët janë disi të çuditshëm. Jo vetëm se janë pak të fantaksur, të hutuar dhe jetojnë mbi ëndërra, por gjithashtu ato, krijojnë ca skena ideale, ku vendosin të jetojnë pa përfillur fare ligjet e jetës së vërtetë. Le të jetë ky tregim pra, një requiem për të gjitha ato aktore të vendit të shqiponjave që sistemi i la mënjanë, i emargjinoi, i harroi, i degdisi larg, i injoroi krejt edhe pse kishin talent dhe pasjon në aktrim.

Herën e fundit që e pa, besoj ka qenë disa javë përpara se të nisej edhe ai vetë për emigrim. Ja mbathi edhe ai. Qyteti s kishte më asnjë kuptim, ndaj kujtimin e mori me vete.

Vite më vonë, pra, i shtyrë nga nostalgjia, kurjoziteti, e gjeti rishtaz Anën në youtube dhe e studjoi me kujdes. Prap mendonte se ajo nuk kishte nevojë t'i kishte zili ndonjë gjë as Brigid Bardosë, as Gina Lolo Brigidës, e as edhe Papas që kishte lozur aq bukur Penelopën me Bekim Femiun. Ajo qëndronte, - ishte i sigurtë -, në të njëjtin nivel me zonjat e rënda të aktrimit europjan. Veç se, e përsëriste shpesh, kishte lindur në vendin e gabuar, në momentin e gabuar. Le të mbesë diçka më tepër mbi letër për të. Garbo-ja shqiptare: Ana Kalt.

"Gjuha, letërsia dhe filmi" i autorit Enver S. Morina

Libër me vlerë mbi personalitetet e çmuara

Nga Bashkim Hoxha

Libri me 15 intervista nga Enver Morina "Gjuha, letërsia dhe filmi" është një kontribut me vlerë në trajtimin e problematikave të letërsisë dhe arteve, por mbi të gjitha, plotëson informacionin e munguar të historisë së vonët të letërsisë dhe arteve këndeje dhe andej Drinit.

E veçanta e këtij libri është sepse janë vet protagonistët e letërsisë dhe arteve që flasin duke na sjellë jo vetëm informacione të bollshme, por edhe këndvështrimet e tyre personale duke zbrëthyer procesin krijues dhe historinë e vonët të letërsisë dhe arteve nga pozicione të ndryshme. Në këtë mënyrë "kamerat" na zbulojnë të gjithë shesh-betejën e krijuesve në përpjekjet e tyre të mundimshme për të ngritur monumentin e artit e letërsisë shqipe.

Ky libër vet është një vlerë shtesë mbi kontributet e shquara që kanë dhënë personalitetet e shquara që janë intervistuar. Përveç krijimeve që analizohen në dialog me autorin e intervistave, ne kemi mundësinë të njihemi edhe me mendimet e tyre të çmuara.

Intervistat e Enver Morinës janë interesante, ato janë gjithëpërfshirëse, e shikojnë artin dhe letërsinë shqipe si një të tërë, pavarësisht specifikave dalluese që kanë kur në mes tyre kalon Drini. 15 personalitetet e përzgjedhur për këtë botim janë ndër kontribuuesit më me vlerë dhe këto intervista janë një dëshmi e plotë se me çfarë problematikash është ndeshur kultura shqiptare për të ruajtur identitetin në luftë me teprinë e kohës, siç kanë qenë skemat statike të realizmit socialist apo presioni për ta globalizuar duke i hequr AND-në e veçorive të shqiptarisë në këto shkrime.

Autori ka ditur të përzgjedhë njerëz që kanë çfarë të thonë. Ata kanë folur së pari me veprën e tyre, më pas me shprehjen e botëkuptimeve të tyre dhe të përvojave, gjë që ka krijuar një gjerdan informacioni shumë të rëndësishëm.

Mjafton të listojmë emrat e tyre, problematikat që janë trajtuar, prezantimin e përmbajtjes së intervistave nga autori, dhe të kuptojmë se sa i dobishëm dhe në kohën e vet është ky libër. Libri "Gjuha, letërsia dhe filmi", botim i "Littera" (2024) përfshin 15 intervista të renditura sipas vitit të lindjes. Ato janë realizuar në një periudhë 21 vjeçare. Fillon me shkrimtarin, regjisorin, përkthyesin e dramaturgun **Gjergj Vlasi**, pastaj me shkrimtarin e skenaristin **Dritëro Agolli**, me albanologun gjerman prof. dr. **Wilfried Fiedler**, me aktorin **Reshat Arbana**, me akademikun **Esat Stavileci**, me dramaturgun e shkrimtarin **Teki Dërrishi**, me shkrimtarin **Skënder Drini**, me akademikun, gjuhëtarin, studiuesin **Rexhep Ismaili**, me shkrimtarin e skenaristin **Natasha Lako**, me regjisorin **Isa Qosja**, me studiuesin, shkrimtarin, profesorin **Sabri Hamiti**; me albanologun **Robert Elsie**, me shkrimtarin e skenaristin **Ylljet Aliçka**, me poetin e skenaristin **Petrit Ruka** dhe e fundit me regjisorin **Bekim Lumi**.

ENVER S. MORINA

GJUHA, LETËRSIA DHE FILMI

LITTERA

FJALA

(Aforistikë)

Kanë thënë se:

fjala ka zjarrin e vet, ruaje mos të fiket!
Po u shua njëherë vështirë rilind e ndizet.
Mbetet përherë veç fjala që nuk thuhet,
për t'treguar se është jona e në ne ruhet.

Kanë thënë se:

fjala nuk shuhet as edhe kur njeriu vdes,
sjell dritën dhe errësirën e bën mëngjes.
Ajo ringjallet si feniksi në rrezen e diellit,
për të rrëfyer t'pathënën e tokës e t'qiellit.

Kanë thënë se:

fjala është rrënja, pema e kurora që jemi,
Të vërtetën e gënjeshtrenë, sa pranë i kemi.
Dashurinë ndez e urrejtjen fik veç një fjalë,
për t'na thënë zëshëm veç ajo mbetet gjallë.

Kanë thënë se:

njeriu është zot i fjalës së vet, si mot e herë,
edhe rob i saj kur të lëkundet si të ishte erë.
Ndonjëherë brenda nesh na mbulon një terr,
veç shkëlqimi i fjalës të këqijat i flak e i bjerr.

Kanë thënë se:

fjala e thënë e shigjeta e nisur s'kanë kthim,
për aq sa kthehen jeta e shkuar e rasti shqim.
Ajo është dhuratë për të fshehur mendimin,
për t'na kthjellë e për t'i gjetur jetës kuptimin.

Kanë thënë se:

fjala mishëron njeriun me mendjen e tij,
dhe si ai edhe fjala ka energji, fuqi, ndjesi.
Kush s'e ka njohur fuqinë e saj as dje as sot,
s' do të mund të ndryshojë askurrë veten dot.

2.8.2023

ATY ISHE TI

(Tim eti)

Kur vononte pranvera nga acari me duhí
e dimri i rreptë ia vidhte ditët pa mëshirësi
ATY ISHE TI,
për të zbutur ngricën e për të sjellë ngrohtësi
e për t'ia ndalë turrin dimrit me tënden mirësi.

Kur qielli gjëmonte e ndillte pa prà frikësi
e përvajshëm ia lëshonte i ftohti rrebesh shí
ATY ISHE TI,
për t'i heshtur gjëmat e tij me plot maturí
e për t'ia fshirë lotët mbushur me njelmësi.

Kur dita agonte e zymtë pa fije bardhësi
e dielli nuk dukej kund as sa për mashtrí
ATY ISHE TI,
për të falur dritë anë e tej qiellit në ajrí
e për të ngrohur tokën me zjarr e shpirtësi.

Kur hëna humbte dritën natën në errësi
e yjet përndaheshin frikshëm n'paskajësi
ATY ISHE TI,
për t'ia shlyer pazëshëm të virgjërën fajësi
e për t'i rikthyer qiellit të kaltrën dritësi.

Kur lulet çelnin bulëzat e fjetura n'breshní
e bari n'fushë thahej pa zënë mirë fara e tij
ATY ISHE TI,
për t'u dhënë fuqi jete pas dimrit t'thatë shkretí
e për të njomur qilimin e blertë me një vesë shí.

Kur zogjtë harronin rrugën e kthimit në shtegtí
e fluturat humbisnin të hirshmen larushí
ATY ISHE TI,
për t'u prirë si fanari në shkëmb t'detit pa kuffí
e për t'u dhënë zemër krahëlehtave në fluturí.

SHEFKIJE
ISLAMAJDuke
pritur
shiun

Poezi



E sot, nëntor, unë ndiej sërish shumë ftohtësi
e ndiej frymën, zërin e tënden fjalë shenjterí
TI JE KËTU
për të m'i dhënë krahë simes pafuqi e ligështí
e për të ma bërë ecjen t'drejtë, pa lak, pa ngushtí.

10.11.2023

ÇAST MALLI

Më thuaj
nanë, kur më solle në këtë jetë, a hoqe shumë?
A shtere kroje e puse pikë më pikë deri në fund?
A çave mure, a grithe tokë kur dola ndritë unë?
Apo shembe kodra, shkëmbinj e trande katund?

Më thuaj
nanë, atë ditë tetori, kur linda unë, a nxehu dielli?
A ra rrebesh shiu, a krisën retë apo u mrrrol qielli?
A u çua shtrëngatë majë bjeshkës për së kthjellí?
Apo u ndie puhí e qetë e erë mokthi e lulesh prilli?

Më thuaj
nanë, më thuaj, a kishe atë ditë shumë të ftohtë,
kur vendosa ta lëshoja shtratin tënd të ngrohtë?
A të shkuan djersët akull apo të zunë ethet fort?
Pashë bukën e ujin, a më trove a m'urove atë mot?

Më thuaj
nanë, kudo të jesh sot, n'parajsë, n'qiell a n'yllësi,
si u ndjeve kur lëshova të qarën e parë në gjithësi?
A u ngjalle a të erdhi fill fuqia e të shenjtes amësi?
Po kur më more në krahë e më dhe së pari gjí?

Më thuaj
nanë, aman mos ma lë peng n'zemër timen fjalë!
Mund të m'thuash: "Pse s'më pyete sa isha gjallë?
Krejt t'i kam thënë ditën që të linda vajzë e jo djalë.
Bijë, mos të ka zënë keq, si mua, i zhurituri mall?"

19.3.2024

VJEN NJË KOHË

(Aforistikë)

Vjen një kohë kur e kupton
se kërkohet nga jeta shumë
e ajo jep sa një freski n'lumë.

Vjen një kohë kur e kupton
se koha kalon vrik e shpejt,
na vjedh çdo ditë nga pak jetë.

Vjen një kohë kur e kupton
se kur bie nata terri çdo gjë hesht,
pos dëshirave që presin në rresht.

Vjen një kohë kur e kupton
se brenda vetes e vetë jetës
acari nuk zbutet aq lehtë.

Vjen një kohë kur e kupton
se dhembja e malli ndër vite
nuk zhbëhen për një pasdite.

Vjen një kohë kur e kupton
se një çast, një ditë a një natë,
vlen më shumë se jeta e gjatë.

Vjen një kohë kur e kupton
se më e vështirë se pritja vet'
është kur e di se dikush të pret.

Vjen një kohë kur e kupton
se heshtja e të vdekurit godet
më fort se fjala e të gjallit kur flet.

Vjen një kohë kur e kupton
se mosha s'të bën më të mençur,
më e shumta të bën më të pjekur.

Vjen një kohe kur e kupton
se kërkohet nga jeta shumë
e ajo jep sa një freski n'lumë.

30.9.2023

DUKE PRITUR SHIUN

Ballë meje, tej mbi pullazet harkore e të kuqe,
retë ngjyrë koralesh luajnë me naze e huqe.
E bardha dhe e hirta këmbehen lehtë e shpejt,
ndërrojnë ngjyrë e përndahen sikur mbi det.

Piklat e vakëta mbushur rrejshëm me shi,
më ngjan se lagin qetë ballin e flokët e mi.
Pres të shpeshtohen e t' më sjellin fllad e puhí,
ato me bubullimën ikin trembshëm me furi.

Prita kot në ballkon të zbutet sado pak vapa,
sa çudi, shiu ndërroi mendje e u kthye prapa.
Kur shiu e fresku mbetën dëshirë e vegim,
heshtja e gjysmerrësira veshën oborrin tim.

Atëherë, mendja ime kryeneçe fluturoi përtej,
preku fllad pishash e erë deti e u kthye këtej.
Desha të zemërohem me shiun e vapën flakë,
por, a ia vlen të shtyhem sonte me motin dinak?

28.7.2022

KUR BIE TERRI

Kur nis e mjegullohet toka e qielli,
fshihet prapa reve i dimrit dielli.
Shuhet drita prajshëm si përditë.
Them më vete: si iku edhe kjo ditë?

Kur muzgu i zyrtë bie pamëshirë,
gjysmerrësira zë timen hapësirë.
Sa çelëshel sytë dhomën zë terri.
i them vetes: sa vrik drita ia theri!

Nga ballkoni shoh si i tund hijet era
dhe dy a tri gjethe mbetur nga hera.
Shekull larg sonte më duket pranvera,
them më vete: po si ishte herë t' tjera?

Qetësia e mbrëmjes shtrihet pa fjalë,
mendja s'më shkon në ballkon të dalë.
Ngrohtësia e stufës m'i bën duart valë,
pyes veten: po mos të ishte ky zjarr?

2.1.2023

NËSE

(Rekuem)

Nëse nisem n'ag dite për n'Çamëri,
do të kthej në Filat, rrugës Egnati',
do t'i bie anës Rrahëzës plot ulli'
e do të ndalem në tonin meskufi,
për t' hequr mall për timen Arvaniti.

Nëse nisem pasnesër për në Pargë,
do të përshkoj brigjet malore varg,
do të sodis bregun e Jonit përqark
e s'do të lejoj t' më dalë kush prag
për t'u ulur mes ullishtës jo aq larg.

Nëse në agim do t'ia mësy Prevezës,
do të mbledh fisin tim përreth tryezës,
do të ngre dolli vere me shije t'shëgës,
do t' llafosim për ngjyrat e verëvjeshhtës,
për të kujtuar lotët e gjëmat e jetës.

Nëse n'muzg do t'plak ditën n'Janinë,
do të ndez një qiri për të madhen zinë,
për bëmat që kanë mbushur historinë,
që i kanë sjellë Epirit namin e lavdinë,
për t'i ndalë në kthim shiun e lotin tim.

18 nëntor 2022

PARAJSA IME

Eca fushës e u ngjita lart në bjeshkë,
mora rreze dielli, thitha ajër plot jetë,
vrapova zallit e u zhyta thellë në det,
njelmësia e tij ma skuqi lëkurën lehtë,
por, parajsën time aty s'e gjeta dot.

Desha t'i ndalja valët e detit t' njelmët,
që përplaseshin idhnueshëm në breg,
u fala zemër peshqve shikimkthjellët,
ndjeva mallin flakë që pandalshëm djeg,
edhe aty parajsën time e kërkova kot.

Iu ngjita lart të bardhave rë, shpirtqetë,
qëndrova mbi to si një zog mbi oqean,
frymëmarrja ime rrihte si orë, sa shpejt,
ndjeva se cakut të qiellit iu afrova pran',
as aty parajsën time s'e gjeta dot.

Brigjeve me sy përshkova ara e brezare,
preka kurora pemësh që tundeshin në erë,
plaka ditën në diell, natën n'hënë bujare,
ndjeva se po rijetoja fort timen "pranverë",
por askund parajsën time s'e gjeta dot.

Me sytë e mendjes tej e përtej degdisa,
askund zë, lëvizje, frymë, kudo qetësi,
shova të zjarrtin mall e ëndrra qëndisa,
ndjeva të magjishmen tëndën ngrohtësi.
ATY gjeta parajsën, parajsa ime je ti.

9.7.2024

Nga presioni shoqëror te kategoritë estetike;
Gratë që bënë letërsi me pseudonime burrash
**GEORGE ELIOT, J. K. ROWLING,
CHARLOTTE BRONTË**
dhe revolucioni autorial letrar


Nga Jola Tasellari

Akti i përdorimit të pseudonimeve mashkullorë prej shkrimtareve gra përbën një aspekt interesant në rrjedhën e zhvillimit letrar që ka provokuar vazhdimisht letërsinë deri në fundshekullin e nëntëmbëdhjetë. Mandej, shekulli i njëzet dhe njëzet e një, me tërësinë e zhvillimeve sociale me karakter feminist duket sikur e zbehën dhe gati e zhdukën këtë fenomen, duke i dhënë grave hapësirë, medium dhe zë në arenën letrare. Ky fenomen shfaq në vetvete jo vetëm lidhjen komplekse që prej shekujsh ka ekzistuar mes gjinive, autorësisë dhe pritshmërive shoqërore, por dhe mundësitë e pamundësitë e navigimit në botën letrare, e cila vijonte të mbizotërohej prej zërave mashkullorë.

Por a mundet shoqëria jonë sot t'i kuptojë (në mos mirëkuptojë) kushtet të cilat ndikuan lindjen dhe zhvillimin e këtij fenomeni, arsytet pas kësaj zgjedhjeje dhe nëse sot, me këtë zhvillim të rrufeshëm gjinor që po hasim, a mbetet një strategji e tillë ende e arsyeshme, apo...?

Historia e letërsisë ka dëshmuar ndër shekuj se perceptimi publik i grave si *shkrimtare* është formësuar prej nënshtrimit nga normat gjinore. Në shekujt e XVIII-të dhe XIX-të, kur shumë nga figurat më të famshme letrare (të cilët ende cilësohen sot si zërat më të rëndësishëm të kohës) ishin në zenitin e tyre, gratë vijonin të kufizoheshin në role shtëpiake dhe nuk konsideroheshin si mjaftueshëm të afta për të zhvilluar jetën intelektuale, filozofike dhe letrare të kohës. Pyetjes se nëse ekziston koncepti i një *diskursi të veçantë femëror*, Simone de Beauvoir, zgjodhi t'i përgjigjej me një *jo* të prerë, ndonëse në kontekstin feminist. Por historia dhe zërat e saj ndodhin të na dëshmojnë disi të kundërtën.

Fundshekulli i nëntëmbëdhjetë dhe veçanërisht ai i njëzet në Evropë dhe Amerikë u karakterizuan nga një numër i madh shkrimtareësh gra, të cilat më në fund po shijonin plotësisht lirinë e shkrimit dhe eksplorimit në botën e letërsisë, pa droje nga gjykimet shoqërore në rastin më të mirë, apo refuzimet për shkak të normave që ndër të tjera përfshinin dhe ato gjinore. Madje, kjo liri e re dhe krejt ekzotike për



seksin tjetër stimuloi kësajsoj edhe kureshtjen mbi një botë të ndryshme dhe të re artstike, gati sikur kishim të bënë vërtetë me një gjuhë tjetër. Ndonëse kurrsesi s'mund të jemi plotësisht të prerë, sepse ekzistojnë dhe plot shembuj pseudonimesh si ai i J. K. Rowling, e cila, megjithëse në një kontekst më modern, zgjodhi t'i publikonte romanet e saj kriminalistike me pseudonimin Robert Galbraith. Edhe pse vendimi i Rowling nuk ishte një reagim drejtpërdrejtë ndaj diskriminimit gjinor, ai thekson se, edhe në bashkëkohësi, një shkrimtarE mund të ndiejë nevojën për të krijuar një identitet tjetër letrar për të pasur lirinë krijuese.

Megjithatë, inversi i këtij konteksti kulturor që kish' mbizotëruar letërsinë prej shekujsh, e bëri terrenin e vështirë për gratë që të botoheshin apo t'u njihet talenti letrar. Kufizimet nuk ishin vetëm shoqërore, por edhe institucionale. Gratë përjashtoheshin nga shumë qarqe letrare, ishin gati të marginalizuara dhe shpesh shkrimet e tyre me karakter letrar vinin për lexuesit sikur të ishin prej shkrimtarëve burra, qofshin këta familjarë realë, apo pseudonime të krijuara.

Një nga shembujt më të famshëm është ai i Mary Ann Evans, e cila shkroi nën pseudonimin George Eliot. Vendimi i saj për të përdorur një pseudonim mashkullor ishte strategjik; në atë kohë, romanet e shkruara nga gratë shpesh konsideroheshin si shumë sentimentale ose romantike, ndërkohë që veprat me natyrë më filozofike dhe realiste pritej të mbanin burra si shkrimtarë. Duke përvetësuar pseudonimin George Eliot, Evans siguroi që romani *Middlemarch*




(1871–1872) të merrej seriozisht në fushën e kritikës intelektuale dhe letrare dhe të mos refuzohej prej kësaj të fundit.

Po ashtu, Charlotte Brontë, ndonëse nuk është aq e njohur për përdorimin e pseudonimit të saj, fillimisht i publikoi veprat e para nën pseudonimin Currer Bell. Motrat e saj- Emily si Ellis Bell dhe Anne si Acton Bell, po ashtu përdorën pseudonime kur shkruan vetë. Kjo praktikë funksionoi pjesërisht si përgjigje ndaj stigmatizimit të shkrimtareve gra dhe pjesërisht si një dritare e re nga ku mund të shkruanin pa u gjykuar dhe, në rastin më të mirë, të botoheshin dhe lexoheshin në masë.

Në shekujt XIX dhe XX, sfera publike—sidomos ajo letrare dhe intelektuale—ishte e ndarë sipas gjinive, me burrat që mbanin pozita fuqie, autoriteti dhe legjitimiteti dhe shkrimtaret gra që shpesh ishin të kufizuara në atë që konsiderohej si *letërsi femërore*, që sollën me vete dhe tërësinë e letërsisë rozë, siç ishin romancat apo tregimet me karakter më sentimental. Kjo ndarje dukshëm kontribuoi në thellimin e hendekun në keq-perceptimin e letërsisë së mirë, cilësore, të fortë dhe asaj që nuk ishte fare e këfillë.

Megjithatë sot, pyetjes nëse përdorimi i një pseudonimi do të konsiderohej ende një strategji e arsyeshme në kulturën moderne letrare për gratë, do të duhej t'i përgjigjeshim me kujdes. E para sepse rrezikojmë të dalim nga koherenca me realitetin sot dhe e dyta sepse duhet të mbajmë parasysh se bota perëndimore nuk është e mjaftueshme për të dhënë kategorikisht një përgjigje mbi këtë pyetje. Forumi Ekonomik për Botën, pasi ka analizuar të dhëna nga Biblioteka e Kongresit, shtëpi të ndryshme botuese dhe platforma të shitjeve të librave, mbërriti në përfundimin se qysh prej vitit 2020 gratë po dominojnë mbi burrat jo vetëm në shitje, por edhe në shkrime të letërsisë artistike, pa përmendur këtu punën shkencore apo libra studimorë të cilat nuk janë llogaritur prej tyre (po ashtu dhe gratë botuese janë 20% më shumë se vitin 1970 dhe janë rritur me 50% në vitin 2020.

Shkrimtaret gra sot kanë më shumë mundësi për të botuar sesa homologët e tyre nga dy shekujt e kaluar. Po ashtu, zhvillimi i kritikës letrare feministe, lëvizjeve të ndryshme letrare dhe fuqia e internetit dhe platformave që njihen si *vetë-botuese* u kanë ofruar grave mundësi të reja dhe kanë sheshuar hendeqet ekzistuese. Shkrimtare si Margaret Atwood, Zadie Smith, Elif Shafak, Han Kang dhe plot të tjera të këtij shekulli, kanë lënë gjurmën e tyre të pakthyeshme në botën letrare pa pasur nevojë për pseudonime mashkullorë. Kjo për të shprehur një herë e mirë rëndësinë e faktorit *kontekst kohor* kur bëhet fjalë për të sjellë në vëmendje fenomene delikate të zhvillimit të letërsisë, ku bën pjesë edhe raporti i grave me krijimtarinë letrare.



Po prisim të shikonim premierën botërore, “Hamlet - Tragedy of the Prince of Denmark” të Shekspirin në “Harris Theater”, një ndër më të rëndësishmit në Chicago, pranë Millennium Park, aq shumë i njohur dhe po aq shumë i vizitueshëm, një teatër që të ofron një hapësirë moderne dhe shumëfunktionale për shfaqje të ndryshme artistike, veçanërisht për artet performative. Me rreth 1.500 vende, pra me një audiencë të madhe, por gjithashtu dhe intime për të të siguruar dhe një lidhje sa më të afërt të publikut me teknologjinë e avancuar, infrastrukturën moderne, përshtatshëm për shfaqje komplekse e të sofistikuara bashkëkohore.

Do të shkonim te “Hamleti”, duke rezervuar biletat muaj më parë, duke patur dhe një si ndjesi hakmarrjeje, unë, estetikisht, se kryevepra shekspiriane, që e doja me shumë nga të tjerat, do të ishte pa fjalën, - o tmerr!, - mëmërita, - një interpretim unik dhe ndërdisiplinor, - lexova, - me regjisorin legjendar Robert Lepage, me balerinin dhe koreografin e njohur Guillaume Côté.

Produksioni do të ishte një bashkëpunim ndërmjet kompanive “Ex Machina”, “Côté Danse dhe Dvoretzky Productions”, - s’më interesonin dhe aq, - me muzikën origjinale nga John Gzowski, një përzierje instrumentesh, harpash dhe kitarës elektrike, etj, etj.

Dhe tani premiera amerikane e fundnëntorit, pas suksesit në Toronto dhe në Festivalin Ndërkombëtar të Shekspirin në Rumani.

SHFAQJE MAHNITËSE

Përshtatje moderne e jashtëzakonshme e klasikes së pavdekshme, një eksperiment artistik i guximshëm që riimagjinon dramën përmes një gjuhe universale – kërcimit dhe lëvizjes, pa dialog tjetër, një qasje ndryshe, e përqendruar te emocionaliteti dhe dinamika vizuale, mbisunduese, përforcim i ndikimit psikologjik të historisë.

Duke përdorur vetëm gjuhën trupore për të rrëfyer tragjedinë, dashuritë, dhimbjet, dyshimin, tradhtinë, hakmarrjen – tematikat kryesore të “Hamlet”, - duke shprehur mendimet dhe ndjesitë ashtu, vepra sikur sfidonte idenë tradicionale të teatrit. Multisensorialiteti, muzika dhe kërcimi intensiv, ndryshimet në ndriçimin inovativ, loja me hijet, etj, krijojnë një mjedis metaforik që thellonte marramendshëm përjetimin e konfliktit të brendshëm të Hamletit, dalldinë, e kthyer në ngjarjet përreth me një dimension poetik.

Shumëçka erdhi me shumëçka, një narrativë tronditëse pa fjalën, por me lëvizjet që nga më të qetat dhe paqësoret plot delikatesë dhe sensualitet e deri te më të furishmet, gjithë marrëzi dhe delir, duke tejkaluar përtej asaj që ka qenë tekst, duke shprehur mendimet dhe ndjesitë, e gjitha me artin e kërcimit dhe gjuhës trupore, duke mbivlerësuar aspektin emocional dhe shqisur të shfaqjes.

FJALA E HESHTUR - GJUHA E TRUPIT...

Po “E para është fjala” – mendova, kumt që vjen nga tradita biblike dhe

NJË HAMLET PA FJALËN. BALETI I TRAGJEDISË DHE EMOCIONEVE UNIVERSALE

Nga Visar Zhiti

filozofike, duke theksuar fuqinë krijuese dhe simbolike të logosit.

Natyrisht që i referohet rolit të gjuhës së folur dhe të shkruar në strukturimin e mendimit, në komunikim dhe në krijimin e realitetit.

Megjithatë **gjuha e trupit është një formë komunikimi** e fuqishme, po ashtu e hershme, madje dhe më e hershme, që gjithsesi ka qenë më përpara zhvillimit të gjuhës së folur.

Pra, gjuha e trupit mohohet apo thjesht vendoset në një rrafsh tjetër?

Nëse i qasemi nga këndvështrimi evolucionar, trupi ka qenë mjete i parë për shprehje (mimika, gjestet, etj.), ndërsa fjala është një zhvillim i mëvonshëm dhe shpesh i atribuohet fillimit të ndërgjegjes dhe arsyes. Në këtë sens, “E para është fjala”, mendoj se nuk e përjashton gjuhën e trupit, por përqendrohet te rëndësia e komunikimit të menduar dhe të qëllimshëm.

Atëhere kemi dhe fjalën e heshtur, që domosdoshmërisht mund të mos jetë një tingull apo tekst, por një formë e komunikimit që mbart kuptim, edhe pa zë.

Gjuha e trupit, me shikimet dhe kuptimësinë e tyre, përbën një formë heshtake të të shprehurit dhe ndodh të thotë sa fjala e folur, në mos dhe më shumë në shumë raste si shprehje e thelbit të brendshëm.

Gjuha e Trupit është fjala para fjalës – një mënyrë natyrore për të komunikuar më herët se të zhvillohej gjuha e artikuluar. Ndërkaq ajo është dhe një zgjatim i fjalës, që mbështet dhe plotëson atë që thuhet, shpesh duke shpjeguar atë që nuk thuhet me zë.

Atëhere fjala ekziston edhe kur heshtim. Kur themi “E para është fjala”,

nuk mohohet gjuha e trupit apo forma e heshtur e komunikimit.

Kur dhe një prekje dore është formë e komunikimit apo duartrokjetet në teatër, fjalë me format e saj, e heshtur apo e folur, është intenca dhe kuptimi që përpiqemi të përcjellim, me trupin, mendjen dhe shpirtin.

Gjuha e trupit është një pjesë thelbësore e komunikimit dhe madje mund të jetë më e sigurtë. Një shikim mund të thotë të vërtetën kur fjala s’e thotë.


Fjala e parë, në këtë kuptim, mund të jetë heshtja vetë – një heshtje që flet përtej fjalëve, e ngritur në art.

Unë mendoj se fuqia e artit të madh qëndron në shndërrimet dhe besnikërinë. Tensioni mes këtyre dy gjendjeve është shpesh burimi i mrekullisë së tij.

Hamleti që vallëzon dhe nuk flet, është një vepër krejtësisht legjitime, interpretimi i së cilës na fton të dalim përtej Shekspirin, por nëpërmjet Shekspirin, një kompromis për të mbajtur lidhjen me origjinën, që ndoshta nuk ishte më e nevojshme. Të paktën në këtë rast.

A MUND TË QUHET VEPËR DASHURIE?

Sipas meje kështu duhet të jenë dhe janë veprat e artit. Baleti “Hamlet” në Harris Teatër në një mënyrë të ndërlikuar e të shumëanshme eksploron dashurinë në të gjitha format e saj komplekse deri në tragjizëm: dashuria romantike mes Hamletit dhe Ofelisë, dashuria e përzier me tradhti dhe dinakëri brenda familjes mbretërore dhe dashuria e pakthyeshme ndaj së vërtetës dhe drejtësisë, që në fund çon drejt shkatërrimit. Dashuria këtu nuk



Në Harris Theater, Chicago

është thjesht një ndjenjë e pastër, por një forcë që ndikon vendimet, veprimet dhe fatin e personazheve. Në këtë kontekst unë këtë vepër e pashë si një vepër dashurie që përshkruan pasionin e fuqishëm dhe humbjen që vjen nga të përkushtuarit për të bërë kohë.

(TRE) ROLET KRYESORE

U interpretuan nga një kastë e shkëlqyer e balerinëve me sfond të pasur artistik dhe përvojë ndërkombëtare:

1- Guillaume Côté – në rolin e Hamletit, - është një nga figurat më të njohura të baletit klasik si solist kryesor dhe koreograf i shquar i National Ballet of Canada. Me një karrierë që zgjat prej më shumë se dy dekadash, ai i dha personazhit të Hamletit një interpretim kompleks dhe introspektiv. Kjo është një nga shfaqjet e tij të fundit...

2- Greta Hodgkinson – në rolin e Gertrudës, - soliste kryesore e National Ballet of Canada, solli një prani të fuqishme dhe një gjuhë të veçantë të lëvizjes që pasqyron elegancën dhe tramën e personazhit.

3. Ofelia dhe vdekja e saj:

Koreografia e Côté-së e përqendron energjinë në vetminë dhe dëshpërimin e personazhit. Lëvizjet e Carleen Zouboules (Ofelia) ishin të zbutura, por të ngarkuara emocionalisht, duke reflektuar paqen e trembur të pranimit të fatit. Ndriçimi i zbehtë dhe përdorimi i projeksioneve krijuan një efekt vizual që paralajmëronin ndarjen e saj nga bota reale.

Skena e vdekjes së Ofelisë ishte një nga kulmet emocionale të baletit.

Në vend që vdekja të përshkruhej fizikisht, ajo ndodhi përmes një shndërrimi metaforik, një përzierje e ujit dhe ajrit, duke e bërë këtë skenë jashtëzakonisht poetike dhe prekëse.

TEATËR BRENDA TEATRIT

Hamleti, siç dihet, inskenon një shfaqje teatrale për të nxjerrë në pah fajësinë e mbretit Klavdi. Koreografia këtu përdor një stil të jashtëzakonshëm metateatror, ku lëvizjet e trupave të balerinëve krijuan tension dramatik dhe një ndjenjë të theksuar manipulimi. Kostumet e bardha dhe ndriçimi i fortë theksojnë ndarjen midis realitetit dhe lojës së shtirë, duke përforcuar idenë e teatrit si një pasqyrë e së vërtetës.

Loja brenda lojës u shndërrua në një mjet dramatik për të nxjerrë në pah dinamikat emocionale të personazheve.



HAMLETI ME KAFKËN

Kur ai mban kafkën në dorë, (skena "Ah, Yorik i gjorë"), u arrit interpretimi fizik i përsiatjeve mbi vdekjen dhe kalueshmërinë e jetës, prandaj të përqendrur nuk mbetet thjesht në një objekt statik.

Hamleti rreth kafkës ndërton një vallëzim introspektiv, me lëvizje që sugjeronin pasiguri dhe melankoli. Ndrëimi dhe muzika intensifikohen për të krijuar një mjedis meditativ, duke bërë të ndjehet fryma filozofike hamletiane mbi jetën dhe vdekjen.

FANTAZMA E FROJIDIT
ME KOMPLEKSIN E EDIPIT

Vonë, në shekullin XX, Sigmund Freud ofroi një interpretim të veçantë të Hamletit përmes teorisë së kompleksit të Edipit. Sipas tij, Hamleti nuk e vret Klavdin menjëherë nga që ai kishte kryer një akt që Hamleti në mënyrë të pandërgjegjshme dëshiron: largimin e babait dhe uzurpimin e rolit të tij si partner i Gertrudes.

Ky këndvështrim, megjithëse nuk mbështetet nga të gjithë studiuesit, ka ndikuar shumë në mënyrën se si është interpretuar dhe shfaqur drama e modernizuar në skenë dhe ekran.

Laurence Olivier në filmin e tij të famshëm të vitit 1948, vendosi një theks të madh mbi marrëdhënien nënë-bir duke sugjeruar një ngarkesë emocionale dhe fizike të dyshimtë.

Në disa produksione të tjera, scena e dhomës së Gertrudës (Akti III, Skena IV) është inskenuar në mënyrë të tillë duke na shfaqur një afërsi të papërshtatshme midis dy personazheve.

A janë këto elemente të Shekspirin?

Këto interpretime nuk janë të qarta në tekst, por bazohen në lirinë e leximit të shenjave dramatike dhe emocionale të veprës. Shekspiri shpesh lë hapësirë për dykuptimësi dhe shtresime të ndryshme emocionale, duke i lejuar secilës gjeneratë ta lexojë veprën sipas perspektivës së saj.

Edhe në Hamletin e "Harris Theater" ajo dozë e vogël frojdzimi ishte një zgjedhje artistike, një dimension modern psikologjik për të thelluar tensionin dramatik midis Hamletit dhe Gertrudës.

Ndoku mund të nënkuptohej një afërsi e pazakontë midis tyre.

Nëse ka një si puthje në buzë, kjo është një zgjedhje regjisoriale për të theksuar përzjerjen e dashurisë dhe konflikteve që ekzistojnë midis këtyre dy personazheve.

Puthja mund të mos nënkuptojë domosdoshmërisht një konotacion seksual, por mund të simbolizojë dyshimin dhe tensionin që mbizotëron midis dashurisë së Hamletit për nënën e tij dhe zemërimit ndaj saj për martesën me Klavdin.

Këto janë shtesa të interpretimit bashkëkohor dhe mund të mos jenë të pranueshme për të gjithë shikuesit apo lexuesit e veprës. Gjithsesi, baleti ka lirinë të riimagjinojë historinë edhe me një ndikim të teorive frojdiane për t'i dhënë veprës një thellësi të re dhe shtjellime komplekse, në një mënyrë që të rezonojë me audiencën moderne.

PYETJE JO DHE AQ HAMLETIANE
DHE PËRGJIGJE VETES

"Hamleti" si balet në Teatrin "Harris" në Chicago, ka humbur apo është transformuar?



Çdo adaptim është një dialog i ri me origjinalin. Baleti ofron një qasje më universale, që mund të prekë më shumë ata që nuk janë familjarë me fjalët e Shekspirin.

Fjala është bërë lëvizje. Idetë dhe emocionet janë përkthyer në një gjuhë vizuale trupore, duke shtuar një shtresë të re ndjeshmërie.

- Çdo interpretim modern rikthen veprën si pjesë të kulturës dhe i shton gjithëkohësi.

Edhe një herë pyes: a kemi humbur, kur fjala largohet?

Forca e tmerrshme e Shekspirin qëndron tek thellësia e gjuhës së tij dhe është pamundur të mos ndërmendësh këtë mungesë çekuilibruese, edhe duke mos qenë shekspirolog. Po fjala mund të jetë e rroposur thellë brenda njeriut dhe shfaqet me forma të ndryshme, e thamë.

Baleti nuk ka për qëllim të zëvendësojë origjinalin, por është një mënyrë për ta zgjeruar kuptimin e tij.

Përsëritja e strukturës, fabulës, e disa skenave ikonike të "Hamletit" ishin një mënyrë për të ruajtur lidhjen me origjinalin dhe për të siguruar shikuesin që po shohim Shekspirin, ta njohë Hamletin e tij edhe brenda këtij formati të ri.



Pra ishim në një urë apo në mur magjepsës, para të cilit vallëzohej? Krijuesit e tij duke u çlidhur me të kaluarën e veprës, mos kanë dashur të shkojnë plotësisht përtej saj?

Nëse baleti na dha ndjesinë e një veprë të re, atëherë ai e tejkaloi thjesht interpretimin dhe krijoi risi, të pavarur nga origjinali.

Shfrytëzimi i famës së një veprë me një emër të njohur botëror si "Hamleti" mos është garanci për suksesin artistik apo komercial të veprës së re? Të jetë kjo një strategji që përdoret në shumë gjini të artit, nga teatri në kinematografi dhe në balet? Mos i duhej audiencës dhe jo dhe aq ose fare autorëve, që ndoshta sigurisht e shohin krijimin e tyre si një vepër më vete?

Kjo mund të ndihmojë në rritjen e interesit dhe të pjesëmarrjes, përndryshe mund të duket abstrakte ose e largët.

Shumë artistë që bëjnë adaptime, nuk e shohin famën si garanci, por si sfidë. Ata përpiqen të gjejnë një mënyrë për ta nderuar origjinalin, ndërsa e kalojnë atë në një gjuhë tjetër, të tyren artistike.

Për autorët e baletit "Hamleti", vepra e Shekspirin është një trull i pasur për eksplorim, jo thjesht një markë, megjithë rrezikun e hijes së origjinalit si lartësi e

madhe që mund të mbulojë veprën e re si nismë.

Nga ana tjetër, nëse vepra e re arrin të përçojë një ide të freskët ose të zgjerohet thelbin e origjinalit përmes gjinisë së saj siç bëri baleti "Hamlet" në "Harris Theater", atëherë ajo ka potencialin të qëndrojë më vete, pavarësisht lidhjes me origjinalin.

Baletin "Hamlet" shihet si një homazh ndaj Shekspirin, që ia ka dalë çlirueshëm të fitojë një jetë të re.

* * *

"Hamleti" i Harris Theater na kujtoi se artet performative kanë fuqinë të kapërcejnë kufijtë e fjalëve dhe të na çojnë drejt një përvojë të pastër emocionale.

Ndërthurja mes koreografisë së fuqishme, muzikës së ndjerë dhe ndrëimit vizionar, ofroi një përkthim modern të një teme universale: luftën e brendshme të shpirtit njerëzor. Ndërkaq me këtë shfaqje, Harris Theater gjithashtu ftoi audiencën të reflektonte mbi format e reja të interpretimit, duke e kthyer klasiken në diçka të freskët dhe befasuese duke sfiduar konvencionet për të sjellë një përvojë ku fjala i la vend një gjuhe universale – atë të trupit dhe emocioneve.

Me këtë shfaqje, artistët Robert Lepage dhe Guillaume Côté ofruan një vizion të ri për tragjedinë shekspiriane, një dialog të heshtur, por të fuqishëm.

Risi të tilla na kumtojnë se artet ndërveprojnë dhe nuk janë vetëm pasqyrim i të kaluarës, por edhe hapësirë për eksplorime të guximshme që sfidojnë perceptimet tona. Klasikët mund të marrin jetë të re në duart e mjeshtërve bashkëkohorë. duke e shndërruar veprën e tyre në një dialog të përhershëm mes së kaluarës dhe të ardhmes për të shqiptuar ndjenjat e përjetshme të njerëzimit.

PARA SE TË MBYLLET PERDJA,
SHEKSPIRI, NËSE DO TË SHIHTE
KËTË BALET?

E përfytyrojmë dot? Shekspiri duke parë këtë balet modern të "Hamletit" të tij. A do ta pranonte si ne nga mënyra se si ajo është rikrijuar në një formë krejtësisht të re?

Si një gjeni i teatrit dhe hulumtues i shpirtit njerëzor, mjeshtër i fjalës, Shekspiri a do ta vlerësonte aftësinë e kësaj shfaqjeje për të përcjellë konfliktet e brendshme jo si i ka shkruar ai, por përmes lëvizjes dhe estetikës vizuale?

Shekspiri, i njohur për eksperimentimin me format e dramës dhe të teatrit në kohën e tij, me shumë gjasa do të ndjente një krenari të heshtur, mund t'i shihej e shfaqur me gjuhën e trupit, fakti se krijimi i tij vazhdon të frymëzojë. Ai mund të meditonte mbi universalen e veprës së tij dhe se si thellësia e Hamletit nuk kufizohet nga fjala, por mund të gjendet në çdo formë gjuhe artistike.

Për më tepër Shekspiri ndoshta do të ishte i intriguar nga baleti dhe simbolikat e tij, nga ndrëimet marramendëse e muzika shungëlluese, nga skenat që shndërrohen përmes hijesh dhe transparencës dhe mbase do të thoshte: "Kjo është vetë ajo që kam kërkuar, teatër të shpirtit, një vend ku njeriu dhe hija e tij bashkëjetojnë."

Në fund edhe do të buzëqeshte duke shtuar: "Nëse arti ynë u ringjallka dhe kështu pas shekujsh, atëherë e ka(m) fituar betejën e përjetësisë."



Karikaturë nga Arben Mexsi